

Liridona Sinishtaj • Eljon Doçe

NGJYRAT E JETËS

LETËRSIA 7

Për klasën e shtatë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2020

Liridona Sinishtaj Eljon Doçe

NGJYRAT E JETËS

LETËRSIA 7

PËR KLASËN E SHTATË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT

BOJE ŽIVOTA

KNJIŽEVNOST 7

PRIRUČNIK ZA SEDMI RAZRED OSNOVNE ŠKOLE

Botuesi: *Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë*

Për botuesin: *Pavle Goranoviq*

Kryeredaktor: *Radulle Novoviq*

Redaktor përgjegjës: *Llazo Lekoviq*

Redaktor i librit: *Dimitrov Popoviq*

Recensues: *Dr. Rrok Gjollaj
Mr. Sehad Lulanaj
Lumnije Metanoviq
Prof.Dr. Gëzim Dibra
Mr. Ardita Kokaj-Kovaçi*

Dizajni dhe faqosja: *studio ZUNS*

Korrektor: *Dimitrov Popoviq*

Redaktore teknike: *Dajana Vukçeviq*

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2383-6
COBISS.CG-ID 17048836

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 10903-119/20-3335/15 të datës 24. 07. 2020
e miratoi këtë komplet të Tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2020

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
Martin CAMAJ: Dy gjana print m'thanë kur ishin gjallë	7
Ernest KOLIQI: Tregtar flamujsh	9
Krijimtari POPULLORE: Rozafati (I ra megjulla Bunës...)	11
Enver GJERQEKU: Vdekja s'është fjala e fundit (Ganimete Tërbeshit)	14
Popullore: Bariu i urtë	17
Fan S. NOLI: Syrgjyn vdekur	20
Fridrih SHILER: Vilhelm Teli (Fragment)	23
Popullore: Fjala e hidhur s'harrohet	26
Projekt: Miqtë e mi të veçantë	28
Faik KONICA: Malli i Atdheut	30
Din MEHMETI: Mërgimi	32
Lasgush PORADECI: Mëngjes	34
Ismail KADARE: Një mbrëmje në Lurë	36
Dritëro AGOLLI: Lejleku	38
Gjergj ZHEJI: Poeti i vogël	40
Naim FRASHËRI: Dëshira e vërtetë e shqiptarëve	42
Hajro ULQINAKU: Çka flasin pulëbardhat	44
Projekt: Gjurmët historike të vendit tim	46
Ndre MJEDA: Trina (Fragment nga "Andrra e jetës")	48
MIGJENI: Të korrurat	51
Ernest HEMINGUEJ: Plaku dhe deti	54
Mark TUEIN: Një ftesë për Tomin dhe Hakun	56
DITARI I LEXIMEVE	58
Ferenc MOLNAR: Djemtë e rrugës Pal	59
Mitrush KUTELI: Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit	61
Ferit LAMAJ: Dhelpra e Trojës	63
Sulejman PITARKA: Trimi i mirë me shokë shumë	65
Projekt: Një muaj gazetar	67
Mark MILANI: Lekë Ivani nga Trieshi dhe Knjazi i Malit të Zi	68
Rudjard KIPLING: Libri i xhunglës	70
Petro MARKO: Shpella e piratëve	72
Daniel DEFO: Robinsoni në ishullin e pabanuar (Robinson Kruzo)	74
Projekt: Unë Krijoj	76
Hysein BASHIQ: Dalja në diell	77

PARATHËNIE

I nderuar mësues/e nderuar mësuese,

Teksti i librit të mësuesit vjen për Ju si një përpjekje për të rritur më tej rezultatet e punës me nxënësit, duke lehtësuar njëkohësisht punën dhe ngarkesën tuaj.

Udhëzimet e përfshira në këtë tekst janë të natyrës sugjeruese dhe mësuesi/mësuesja ka hapësirën e vet për të ndërtuar një model mësimdhënieje, i cili të integrojë modelin e propozuar këtu, por duke ia përshatur nevojave dhe interesave specifike të nxënësve.

Struktura që ndërton materialin e Librit të Mësuesit për çdo mësim është si më poshtë:

Skeda fillestare e informacionit, e cila përmban të dhënat kryesore të çdo mësimi si: titulli i pjesës së leximit dhe gjinia e saj, emri i autorit, burimet, lidhja e pjesës së leximit me fushat e tjera, metotologjia e mësimdhënies dhe veprimtaritë e zhvilluara, kompetencat e fituara prej nxënësit/nxënësës si dhe rezultatet e arritura.

Hapi I, parashikon sqarime fillestare rreth temës dhe autorit si dhe çdo informacion paraprak (për të drejtuar vëmendjen e nxënësve), leximin në klasë të pjesës, leximin e fjalorthit, fjalëve kyçe etj.

Seksioni **Studim Teksti** përbëhet prej rubrikave **Të kuptojmë tekstin, Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin, Gjuha e tekstit, Detyrë si dhe Për shkrimtarin.**

Hapi II, përqendrohet në rubrikën **Të kuptojmë tekstin**, e cila zhvillohet në klasë dhe duke qenë se përbëhet prej pyetjesh që lidhen drejtpërdrejt me pjesën e leximit, synon të jetë një hapësirë interaktive që synon rritjen e aftësive njohëse nga ana e nxënësit/nxënësës.

Hapi III, lidhet me rubrikat **Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin dhe Gjuha e tekstit.**

Duke u ndërtuar përmes pyetjeve që lidhen me tekstin, por që njëkohësisht synojnë të abstragojnë jashtë kontekstin për të cilin flitet, ky hap synon të nxisë gjykimin kritik dhe përfshirjen aktive në punë në grup të nxënësit/nxënësës. Në mënyrë specifike, rubrika **Gjuha e tekstit**, synon punën konkrete me analizën e tekstit, të paraprirë, sipas rastit, me një përkufizim teorik të termit, i cili lidhet ngushtësisht me pjesën e leximit.

Hapi IV, i kushtohet punës individuale që nxënësi/nxënësja kryen në mënyrë të pavarur, jashtë orës së mësimi dhe që lidhet me rubrikën **Detyrë.**

Shënime, është hapësira e mësuesit/mësueses për të bërë komente, shënime apo vërejtje të caktuara lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Modeli i mësimdhënies që jemi përpjekur të ofrojmë përmes këtij materiali ndihmues, kombinuar dhe me librin e nxënësit, ka si synim që nxënësin/nxënësën ta vendosë në qendër të orës së mësimi, në mënyrë që të nxitet zhvillimi i shprehive gjuhësore dhe aftësive analitike, kritike dhe sociale, përmes nxitjes së debatit në klasë, gjithnjë duke i dhënë përparësi forcimit të gjykimit vetjak të nxënësit.

Duke shpresuar që ky tekst do të jetë një ndihmë e shtuar në lehtësimin e punës suaj drejt rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies së lëndës së Letërsisë për klasën e shtatë, ju urojmë punë të mbarë!

Me respekt,
Autorët

Martin Camaj

DY GJANA PRINT M'THANË KUR ISHIN GJALLË

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Dy gjana print m'thanë kur ishin gjallë

Autori i pjesës së përzgjedhur: Martin Camaj

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë që i zgjedh mësimmshënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, trashëgimi kulturore

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Interpretim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi dallon stilin e poezisë së M. Camaj, është në gjendje ta interpretojë poezinë, të gjejë figurat letrare, të diskutojë rreth çështjeve që ngrihen në rubrikat përkatëse.

Hapi I

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Dy gjana print m'thanë kur ishin gjallë**

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për autorin Martin Camaj dhe veprën e tij.
- b) Shpjegohet tema dhe disa karakteristika të poetikës së Martin Camaj, si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetjet që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *porosi, prindër, breza, trashëgimi etj.*

Hapi II

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënë, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

- a) Mësuesi/ja çel rubrikën të **KUPTOJMË TEKSTIN** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cila ishte porosia e parë që i kanë dhënë prindërit autorit të kësaj poezie?

Përgjigje 1:

Po qe se shkel ti bukën gand,

Çoje prej dheut, puthe e vene në ballë!

Porosia e parë thekson idenë e respektit ndaj bukës dhe meqë fjala "bukë" ka kuptim polisemik në shqip, përveç kuptimit të parë të bukës si ushqim, ajo nënkupton edhe idenë e respektit dhe të vlerësimit ndaj të mirave që ka dikush.

2. Po porosia e dytë?

Përgjigje 2:

Kur t'rrijsh te votra mbështetë tue pí duhan,

Mos pështýj në zjarm,

Mos pështýj në dritë, pse â keq!

Porosia e dytë rithekson idenë e respektit të të mirave që zotëron dhe shfrytëzon njeriu, sepse fjalët çelës "votër", "zjarm" dhe "dritë", përveç kuptimeve të tyre të parme, kanë edhe kuptime polisemike, përkatësisht: *vatra* ka kuptimin metonimik të *familjes*; *zjarri* mbart

kuptimin metaforik të ngrohtësisë familjare dhe të jetës dhe *drita* ka kuptimin e saj të njohur metaforik si *dije*.

3. Çfarë zotohet të bëjë autori kur të ketë vetë fëmijë?

Përgjigje 3:

Por bijve të mij un kam me u thanë tu'rritë:

Mos shkëlmi bukën,

Mos pështyni në zjarm,

Mos pështyni në dritë.

Autori merr zotimin që kur të rritet edhe ai vetë t'i mësojë fëmijët e tij që të respektojnë vlerat kulturore që prindërit ia kanë mësuar edhe vetë atij. Siç u theksua edhe në përgjigjet e pyetjeve 1 dhe 2, këto vlera dhe norma kulturore përmbajnë idenë e respektit që individit duhet të ketë ndaj familjes, të mirave materiale dhe atyre shpirtërore si dhe përpjekjes që njeriu duhet të bëjë që të trashëgojë vlerat e origjinës së vet nga njëri brez në tjetrin.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale e nxënësit dhe mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

4. Kur autori shprehet "*kam harrue shumë sende që m'i thanë print'*", a mendoni që ka kaluar pak apo shumë kohë nga çasti kur _____

5. Pse mendoni që autori shprehet me fjalët, "*dola ndoshta i larm'*"?

Çfarë tregojnë fjalët "*ndoshta*" dhe "*i larm'*"? A është i sigurt autori se i ka përmbushur deri në fund porositë e prindërve?

6. Si mendoni, a ju ndihmon kjo poezi për të vlerësuar më shumë rrënjët (origjinën) tuaja si dhe faktin se kudo që të shkoni në të ardhmen dhe sado që të rriteni, porositë e të parëve nuk duhen harruar?

7. Gjeni anaforat në këtë poezi:

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Pasi keni lexuar poezinë e M. Camajt, a mendoni për ndonjë porosi që gjyshërit, prindërit apo dikush tjetër më i rritur ju ka lënë dhe që ju mendoni ta plotësoni? Pse mendoni se plotësimi i asaj porosie është i rëndësishëm për ju? Shkruajini mendimet tuaja në formën e një hartimi?

SHËNIME:

Ernest Koliqi

TREGTAR FLAMUJSH

Klasa: VII

Titulli i temës: Tregtar flamujsh

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ernest Koliqi

Burimet: Teksti bazë dhe kërkime në internet për veprimtarinë e Ernest Koliqit

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të analizojë tregimin, të dallojë personazhet dhe elementet e rrëfimit.

Hapi I

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: Tregtar flamujsh

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për autorin Ernest Koliqi.
- b) Diskutohet rreth njohurive që nxënësit kanë për autorin dhe shpjegohen disa nga karakteristikat e tregimit të E. Koliqit.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së tregimit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *simbol, flamur, atdhe, tregti, ideale etj.*

Hapi II

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë personazhet e këtij tregimi?

Përgjigje 1:

Personazhet e këtij tregimi janë Hilush Vilza dhe Gaspër Tragaçi.

2. Ku kishte qenë Hilush Vilza për shumë vite? Për çfarë arsye? Çfarë synonte të bëhej?

Përgjigje 2:

Hilush Vilza kishte qenë jashtë Shqipërisë. Ai kishte shkuar jashtë atdheut për studime. Hilush Vilza ishte mësues dhe synonte të kontribuonte duke përhapur kulturën që kishte marrë nga studimet e tij jashtë vendit.

3. Përse e shmangte vazhdimisht Hilush Vilza dugajën/dyqanin e Gaspër Tragaçit dhe takimin me këtë të fundit?

Përgjigje 3:

Hilush Vilza nuk pajtohej me mënyrën sesi Gaspër Tragaçi e shihte jetën d.m.th. si një marrëdhënie ekonomike, si bilanc shifrash. Për Hilush Vilzën jeta dhe marrëdhëniet njerëzore ndërtoheshin mbi bazën e parimeve morale dhe jo në interes ekonomik, ndaj dhe ai e shmangte takimin me Gaspër Tragaçin.

4. Si është takimi i tyre, i përzemërt apo i sforcuar?

Përgjigje 4:

Takimi i tyre është i sforcuar, pikërisht për arsytet e sqaruara në përgjigjen e pyetjes 2. Hilush Vilza është i detyruar që të takohet me Gaspër Tragaçin si mik i dikurshëm i të atit që i ka vdekur, por jo sepse gëzonte respekt për tregtarin.

5. Për çfarë arsye Gaspër Tragaçi i ka blerë flamujt, sepse është patriot apo se mendon se do të kishte fituar të ardhura prej tyre?

Përgjigje 5:

Gaspër Tragaçi i ka blerë flamujt me qëllimin e vetëm për të përfituar të holla nga shitja e tyre dhe jo për patriotizëm.

6. Çfarë kishte ndodhur, në fakt, me flamujt dhe përse Gaspër Tragaçi iu ankua Hilush Vilzës?

Përgjigje 6:

Gaspër Tragaçi iu ankua Hilush Vilzës për faktin se flamujt që ai i kishte blerë me qëllim shitjeje dhe përfitimi material, në fakt, nuk i ishin shitur dhe ai këtë e shihte si humbje financiare.

7. Si i përgjigjet Hilush Vilza sjelljes prej tregtari të pashpirt të Gaspër Tragaçit kur ky i fundit i trajton flamujt sikur të ishin mall i rëndomtë për shitje?

Përgjigje 7:

Përballë kësaj sjelljeje prej tregtari të pashpirt të Gaspër Tragaçit, i cili flamujt i trajton sikur të ishin mall i rëndomtë, Hilush Vilza mban qëndrim parimor d.m.th. i tregon që flamujt (si simbol i patriotizmit dhe i vlerave kombëtare) nuk mund të trajtohen dhe të barazohen me çfarëdolloj malli që tregtari mbante dhe shiste në dugajën (dyqanin) e tij. Ai e ndalon tregtarin t'i prekë me dorë flamujt, duke i dhënë të kuptojë tregtarit që ky i fundit nuk është i denjë t'i prekë flamujt. Në fund, Hilush Vilza, pas debatit të ashpër me Gaspër Tragaçin, del nga dyqani dhe merr frymë lirshëm, duke ditur që e ka mbrojtur qëndrimin e vet si njeri i kulturuar dhe patriot, i cili nuk i ndërron bindjet e veta para askujt.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që bën nxënësi në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

8. Çfarë ndjesish ka Hilush Vilza për Gaspër Tragaçin? Gjeneri në tekst pjesën ku rrëfëhet kjo gjë.

9. Cili është ai çast në rrëfim kur Hilush Vilza për një çast krijon iluzionin e gabuar se edhe tregtari që ka përballë nuk mendon vetëm për përfitime materiale, por vlerëson edhe idealet e të riut? A zgjat shumë ky iluzion? Pse jo?

10. Cila është pjesa e tregimit që ju pëlqen më tepër? Pse? Zgjidheni dhe rilexojeni në klasë me intonacionin e duhur.

Gjuha e tekstit

11. Kush rrëfen në këtë tregim? Janë vetë *personazhet* apo është *narratori*?

Popullore

ROZAFATI

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Rozafati

Autori i pjesës së përzgjedhur: Nga krijimtaria popullore

Burimet: Teksti bazë dhe materiale dhe informacione shtesë të varianteve të legjendës së Rozafatit, të cilat do t'i japë mësimdhënësi.

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, letërsi gojore, antropologji

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, interpretim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë teksti

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje ta dallojë legjendën si lloj i veçantë letrar, të gjejë figurat letrare, të diskutojë rreth çështjeve që ngrihen në rubrikat përkatëse të libri i nxënësit. Ka informacion për legjenda të tjera nga krijimtaria jonë popullore.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Rozafati**

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për krijimtarinë popullore në përgjithësi dhe se për cilat legjenda kanë lexuar.
- b) Diskutohet rreth legjendave.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për ndjesitë e ngjallura gjatë leximit të legjendës së Rozafatit.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *legjendë, kala, sakrificë, besë, krijimtari popullore etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë nxënësve që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Sa vëllezër punojnë dhe çfarë po përpiqen të bëjnë?

Përgjigje 1:

Tre vëllezër punojnë për ndërtimin e kështjellës.

2. Çfarë ndodh me ndërtimin e tyre gjatë natës?

Përgjigje 2:

Ndërtimi që ata kryejnë ditën u shembet gjatë natës.

3. Prej kujt vjen zgjidhja e këtij problemi?

Përgjigje 3:

Zgjidhja e këtij problemi vjen nga shenjti.

4. Çfarë u kërkon shenjti tre vëllezërve?

Përgjigje 4:

Në vargjet:

N'daçi drejt ju me punue

Të diellën mos punoni,

Lidhni bes e lidhni fé,

*Në konak mos bisedoni,
Vashavet mos u kallxoni!
Nesër nadje t'zbardhmën drita,
Cilla vashë t'i u bjerë bukën
At muronje n'múr t'kalás,
E atëherë keni me pá,
Se kalaj vend ká xânë,*

Shenjti u kërkoi tre vëllezërve të lidhin besën për të mos u treguar grave të tyre se kushti që kalaja të qëndronte në këmbë ishte që e para nuse që do t'u sillte bukën, do të murosej në muret e kalasë së re që po ndërtohej.

5. A e mbajtën të tre premtimin që i bënë shenjtit?

Përgjigje 5:

Jo, ata nuk e mbajtën të tre premtimin që i bënë shenjtit.

6. Cili prej tyre nuk e shkeli premtimin?

Përgjigje 6:

Premtimin e shkeli vëllai i madh dhe i mesëm.

7. Cila prej nuseve të shtëpisë shkoi për t'u çuar bukë dhe ujë të tre vëllezërve tek punonin?

Përgjigje 7:

Ajo që shkoi për t'u çuar bukë dhe ujë të tre vëllezërve tek punonin ishte nusja e vogël e shtëpisë.

8. Si reagon vëllai i vogël kur sheh të shoqen duke ardhur?

Në vargjet:

Kúr e pau i shoqi i saj.

Tretë çakiç e lshon belá,

Tregohet reagimi i vëllait të vogël kur e sheh të shoqen të vijë. Ai hidhërohet shumë.

9. Çfarë porosie u lë nusja e vogël dy kunetërve dhe të shoqit?

Përgjigje 9:

Porosia që u lë nusja e vogël dy kunetërve dhe të shoqit është e dhimbshme dhe njëkohëshit heroike:

Nji amanet-o po ju lâ,

Kúr në múr-o t'më muroni,

Syn e djathtë t'm'a lëni jashtë,

Dor'n e djathë t'm'a lëni jashtë,

Kâmb'n e djathë t'm'a lëni jashtë

Gjin e djathtë t'm'a lëni jashtë

Se e kam lânë djalin të vogël

E kúr t'nisën djali gjâmën,

Me nja'n sy t'a shikjoj,

Me nja'n dorë t'a lëmoj,

Me nja'n kâmbë t'a lurtoj,

Me nja'n gji t'a nërgoj.

Gjûni i êm u nguroftë

E kalaja u forcoftë,

Djali i êm e gëzoftë,

U bâftë krajl e luftoftë!

HAPI III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale e nxënësit në mënyrë të pavarur dhe mund të kërkohet asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë detyrën e caktuar në mënyrë sa

më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

10. Si ju duket fakti që dy vëllezërit më të mëdhenj e thyejnë premtimin që i bënë shenjtit dhe që u tregojnë grave të tyre? A është e ndershme kjo?

11. Qëndrimin e vëllait të vogël, që e mban fjalën, e vlerësoni si qëndrim:

a) burrëror

b) naiv

(Qarkoni shkronjën para përgjigjes së zgjedhur dhe argumentoni përgjigjen tuaj.)

12. A mendoni që vëllai i vogël duhej t'i kishte treguar së shoqes lidhur me atë që shenjt i kishte thënë, në mënyrë që ta shpëtonte atë nga rreziku i murosjes?

13. Po qëndrimi i vetë nuses së vogël si ju duket, kur tre vëllezërit i tregojnë se cili ishte kushti që kalaja të qëndronte? A refuzon ajo që të sakrifkohet për hir të kalasë apo menjëherë e pranon fatin e saj duke e ditur që sakrificat e saj do t'i shërbente një të mire më të madhe?

14. Cili është mesazhi kësaj legjende?

Gjuha e tekstit

Legjenda e Rozafatit që keni lexuar në këtë mësim është e shkruar në vargje, pra ka trajtën e poezisë. Ju mund ta gjeni dhe ta lexoni atë edhe në prozë/rreshta. Cila formë/ trajtë ju pëlqen më tepër dhe ju duket më interesante? Pse?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Jashtë kontekstit epik të legjendës, në një plan më personal, a do të pajtoheshit me idenë se “në mënyrë që të mund të ndërtojmë diçka për të ardhmen, duhet të sakrifkojmë diçka nga e tashmja jonë”? Argumentoni qëndrimin tuaj përmes një hartimi/eseje të shkurtër.

Enver Gjerqeku

VDEKJA S'ËSHTË FJALA E FUNDIT

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Vdekja s'është fjala e fundit

Autori i pjesës së përzgjedhur: Enver Gjerqeku

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poezinë dhe të gjejë figurat letrare.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Vdekja s'është fjala e fundit**

- Pyeten nxënësit, nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për poezinë.
- Bëhet një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga mësuesi/ja.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shpesh për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *sakrificë, kurajë, heroinë, atdhedashuri etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë nxënësve që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Kujt i kushtohet kjo poezi?

Përgjigje 1:

Poezia "Vdekja s'është fjala e fundit, i kushtohet heroinës së popullit shqiptar Ganimete Tërbeshi, e cila ishte pjesë e Luftës Antifashiste në Kosovë.

2. Si e jep autori në këtë poezi qëndrimin e heroinës Ganimete Tërbeshit në çastin e ekzekutimit të saj? A ka frikë ajo nga çfarë pritet të ndodhë?

Përgjigje 2:

Përshkrimi i autorit për qëndrimin e Ganimete Tërbeshit përballë çastit të ekzekutimit është mjaft emocionues, pasi përshkruhet me hollësi e gjithë atmosfera dhe gjendja shpirtërore e heroinës, e cila nuk e jep vetën përballë ekzekutuesve të saj. Ajo nuk ka frikë nga vdekja, në asnjë çast.

3. A ka në poezi ndonjë pjesë që tregon për moshën e heroinës? Gjejini në tekst.

Përgjigje 3:

Vargjet: "Para ëndrrës së **rinisë sapo të çelur**" dhe "Para **vdekjes së hershme** e lirisë në duar" janë ato çaste në poezi të cilat japin të dhëna rreth faktit që heroina Ganimete Tërbeshi është ekzekutuar në moshë mjaft të re.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

4. Cili është portreti moral i heroinës Ganimete Tërbeshi? Cila është karakteristika që ju vlerësoni më tepër te ajo?
5. Sillni shembuj të tjerë të kurajës dhe forcës të femrës shqiptare përballë sfidash dhe situatash të tjera të rrezikshme. A ndiheni ju krenarë që këto femra janë pjesë e historisë suaj?

Gjuha e tekstit

Metafora, fjala metaforë rrjedh nga greqishtja e vjetër dhe do të thotë “bartje” ose “zhvendosje” kuptimi. Përmes metaforës ne i japim një fjale apo shprehjeje një kuptim të ndryshëm nga ajo që thuhet, pra kuptim figurativ. Që në lashtësi, metafora është quajtur “mbretëresha e figurave”. Edhe sot ajo është figura qendrore e stilistikës, ajo përdoret sidomos në poezi. Disa shprehje metaforike janë: natyra qesh, shpirti qan etj.

Rima, është përsëritja e rregullt e një rrokjeje, kryesisht në fund të vargjeve, që theksohet ose zgjatet më tepër në krahasim me të tjerat. Rima është një element thelbësor i poezisë. Rimat mund të jenë disa llojesh si rimë e puthur, e kryqëzuar, e alternuar etj.

Refreni, është një strofë, varg ose fjalë që përsëritet rregullisht në fund të pjesëve të një poezie ose të një kënge. Përmes refrenit rritet efekti muzikor i një poezie.

6. Në fund të çdo strofe ju keni parë që është i njëjti varg, me ndryshime të vogla, që përsëritet vazhdimisht:

Vdekja nuk është **fjala (kënga, klithma, drita, shikimi, xixa, fryma, flatërimi)** ime e fundit.

Përse përdoret nga autori i poezisë një përsëritje e tillë? Çfarë mesazhi përcjell ky varg?

7. Cilat janë figurat letrare që autori ka përdorur në këtë poezi?

Identifikojini ato në tekst dhe shkruajini.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës DETYRË dhe që për këtë orë mësimore është:

Ganimete Tërbeshi sakrifkoi jetën e saj në moshë mjaft të re për hir të idealeve që kishte. Bëni kërkime në internet ose në libra për më shumë fakte nga jeta dhe historia e saj e trishtuar dhe heroike njëkohësisht.

SHËNIME:

Popullore

BARIU I URTË

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Bariu i urtë

Autori i pjesës së përzgjedhur: Popullore

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Letërsi gojore

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë personazhet dhe të gjejë moralin e anekdotës.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Bariu i urtë**

- Pyeten nxënësit, nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për anekdotën.
- Diskutohet rreth krijimtarisë popullore si lloj i veçantë i letërsisë.
- Bëhet leximi i anekdotës nga një prej nxënësve.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shitesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *urtësi, durim, sfidë, rrezik, sukses etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Si e vlerësoni ju faktin që bariu e pranoi pa ngurrim thirrjen e pasanikut për ta vënë atë në provë për zgjuarsinë e tij? A ishte kjo një shenjë mburrjeje nga ana e bariut apo shenjë vetëbesimi në aftësitë e tij?

Përgjigje 1:

Fakti që bariu e pranoi pa ngurrim thirrjen e pasanikut për ta vënë atë në provë për zgjuarsinë e tij, ishte një shenjë vetëbesimi e bariut të mençurisë së tij.

- Si ishte sjellja e pasanikut ndaj bariut të mençur:

- miqësore
- e ftohtë
- provokuese

(Zgjidhni një nga alternativat dhe arsyetoni, duke e mbështetur në tekst, zgjedhjen tuaj.)

Përgjigje 2:

Sjellja e pasanikut ndaj bariut të mençur fillimisht duket se është e ftohtë, madje armiqësore, sepse ai e kërcënon këtë të fundit se po nuk iu përgjigj dy pyetjeve që ai kishte, atëherë do t'i priste kokën, por nga ana tjetër ai pasi e pa që bariu i urtë ishte vërtet i mençur dhe iu përgjigj pyetjeve të tij, pasaniku e la të shkonte.

3. A mendoni se pasaniku kishte vërtet synim që të zbulonte se sa i mençur ishte bariu apo kërkonte me çdo kusht që ta bënte bariun e mençur që të humbiste? Arsyetoni përgjigjen tuaj.

Përgjigje 3:

Fakti që pasaniku e mbajti fjalën e vet dhe pasi bariu i urtë iu përgjigj të dyja pyetjeve të tij, ai e la të shkonte, pa i bërë pyetje shtesë, tregon që vërtet pasaniku kishte si synim që të zbulonte mençurinë e bariut.

4. Si do t'i konsideroni ju pyetjet e pasanikut? Po përgjigjet e bariut të mençur?

Përgjigje 4:

Pyetjet e pasanikut janë të vështira, por përgjigjet e bariut janë po aq të mençura.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të kërkojë të përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

5. Në përrallën e mësipërme keni shprehje si “*të fluturoi koka*” apo “*u zu ngushtë*”. Përse mendoni se në krijimet popullore shprehjet janë të rëndësishme. A do të kishin përrallat të njëjtën vlerë pa këto shprehje? Keni hasur në përralla të tjera shprehje të tilla, tipike të ligjërimit popullor?

Gjuha e tekstit

Anekdota:

Është një tregim i shkurtër humoristik i cili flet për një ngjarje tërheqëse a për të qeshur, të vërtetë a të trilluar, nga jeta e njerëzve të njohur ose që vë në lojë të metat e dobësitë e njerëzve a shpreh një mendim edukues.

Letërsia popullore:

Letërsia gojore (orale) është ajo letërsi e cila shpesh identifikohet me termin “letërsi popullore”. Kjo lloj letërsie është rezultat i një krijimtari kolektive, çka do të thotë që në këtë lloj krijimtari nuk kemi një autor të identifikuar me emër, ndaj dhe gjithnjë autori është populli. Secila nga veprat e letërsisë gojore që na ka mbërritur deri më sot dhe që ne tashmë i lexojmë të shkruara, kanë kaluar nëpër një proces të gjatë modifikimi brez pas brezi, ku secili nga ata “autorë” që ia ka përcjellë një krijim të caktuar brezit pasardhës ka hequr, shtuar apo ndryshuar diçka nga varianti që paraardhësit i kanë treguar atij. Shpesh, nën termin “letërsi popullore” përfshihen përrallat, legjendat, këngë të ndryshme etj, nga të cilat shpesh kanë dalë edhe vepra shumë të rëndësishme të letërsisë shqiptare dhe të përbotshme.

Këshillë:

Një rast që tregon sesi një vepër e letërsisë popullore mund t'i shërbejë një autori për të krijuar një vepër të letërsisë së shkruar është edhe romani “Kush e solli Doruntinën” i I. Kadaresë, i cili është bazuar mbi krijimin popullor, legjendën e Kostandinit dhe Doruntinës. Gjeje dhe lexoje këtë legjendë dhe pastaj romanin e Kadaresë, për të parë sesi prej një krijimi kaq të vogël autori ka krijuar një roman të tërë.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Gjej raste të tjera përrallash apo anekdotash të cilat kanë si tematikë qendrore mençurinë e personazhit kryesor (heroit), shkruaji në fletoren e detyrave të shtëpisë dhe tregoi ato në klasë.

Fan S. Noli

SYRGJYN VDEKUR

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Syrgjyn vdekur

Autori i pjesës së përzgjedhur: Fan S. Noli

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë të zgjedhura nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Analizë, interpretim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e poezisë

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poezinë/elegjinë, ta dallojë atë si një lloj i veçantë poezie dhe ta analizojë.

HAPI I

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: Syrgjyn vdekur

- a) Pyeten nxënësit, nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për elegjinë.
- b) Shpjegohet tema dhe disa karakteristikë krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *vajtim, atdhe, patriot, tradhti, sakrificë*.

Hapi II:

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Poezia e mësipërme është një poezi lirike në të cilën poeti shpreh një ndjenjë të thellë dhimbjeje dhe pikëllimi për patriotin e vranë pabesisht. Kjo lloj poezie quhet ndryshe **elegji**.

Përgjigje 1:

Mësuesi, së bashku me nxënësit, kërkojnë në *Fjalorë të Termave Letrarë*, në hard copy ose në internet, për termin letrar "elegji".

2. Pse vajton poeti në këtë poezi? Çfarë i ka ndodhur L. Gurakuqit?

Përgjigje 2:

Poeti në këtë poezi vajton për vrasjen, në pabesi, të patriotit Luigj Gurakuqi.

3. Cila ndjenjë është ajo që mbizotëron në këtë poezi:

- optimiste
- dhimbje
- gëzimi
- zemërimi
- tjetër

(Qarkoni shkronjën/shkronjat para përgjigjes/përgjigjeve së sakta dhe sqaroni zgjedhjen tuaj duke u bazuar në tekstin e poezisë.)

Përgjigje 3:

Për këtë pyetje alternativat e sakta janë dy: b), dhimbje, sepse për poetin ka vdekur një patriot i madh; dhe d) zemërim, sepse vdekja e patriotit Luigj Gurakuqi nuk ka ardhur nga shkaqe natyrale, por sepse ai është vrarë pabesisht.

Gjithashtu, për këtë pyetje, në dispozicion të nxënësit është edhe alternativa me shkronjën e) tjetër, e cila është vendosur si mundësi zgjedhjeje nëse nxënësi mendon se ka ndonjë ndjenjë tjetër, veç alternativave të propozuara, e cila sipas arsytimit logjik të nxënësit, mund të shtohet plus si alternativë e saktë, krahas alternativave b) dhe d).

Kjo është vendosur për të nxitur më tej të kuptuarit dhe shprehjen e emocioneve nga ana e nxënësit.

HAPI III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

4. Kujt i drejtohet poeti vazhdimisht në fillim të çdo strofe? Cila është "nëna" së cilës ai i drejtohet? A është ajo një person konkret apo diçka tjetër? Argumentoni përgjigjen tuaj.
5. Për kë e ka fjalën poeti në vargun *Larot ta përmbysnë djalin*? Cilët mendoni se janë këta laro? Përse autori ka zgjedhur pikërisht fjalën "laro" dhe jo fjalët "tradhtar" ose "i pabesë"?
6. Çfarë nënkupton autori i poezisë me vargjet:

Nëno moj, ma qaj në Vlorë

Ku të dha liri, kurorë

Çfarë akti patriotik ka bërë Luigj Gurakuqi dhe që autori na e kujton pikërisht përmes këtyre vargjeve?

Gjuha e tekstit

Autori Fan Stilian Noli ka shkruar edhe një elegji tjetër mjaft të njohur për një tjetër patriot shqiptar shumë të rëndësishëm. Kërkojeni dhe lexojeni.

Elegjia (*thirrje rënkuese*) është poezi e shkruar në vargje e cila zakonisht ka tone të trishtuara, vajtuese, rënkuese, mallëngjyese. Ajo mund të ketë subjekte të ndryshme si: vdekja, lufta, dashuria, humbja etj. Elegjia është lëvruar që në letërsinë klasike greke e romake. Në letërsinë shqipe janë të njohura elegjitë e F. S. Nolit, A. Z. Çajupit etj.

Epiteti është një nga figurat më të thjeshta dhe më të përdorura. Ai gjendet lehtësisht, pasi shprehet me një mbiemër që tregon cilësi të spikatura, p.sh.: vashëz bukuroshe, pyje të gjelbëruara etj.

7. Gjeni epitetet e përdorura në këtë poezi:

a) _____

b) _____

c) _____

d) _____

Antiteza (*gr. antithésis- kundërvendosje*) është figurë stilistike që shprehet me anë të antonimeve, duke vënë përballë ide, duke përdorur fjalë e fraza me kuptim të kundërt.

8. Kjo poezi karakterizohet nga disa antiteza të spikatura. Gjejini ato dhe shkruajini:

a) _____

b) _____

c) _____

Fridrih Shiler

VILHELM TELI (FRAGMENT)

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Vilhelm Teli (Fragment)

Autori i pjesës së përzgjedhur: Fridrih Shiler

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, dramë, art skenik

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, interpretim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Interpretim skenik

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të interpretojë pjesën dramatike, të kuptojë sesi funksionon teksti dramatik (dialogu dramatik, skena, personazhet, kostumet etj.), të punojë individualisht dhe të dalë në përfundime vetjake në rubrikat TË ANALIZOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN, GJUHA E TEKSTIT si dhe të përfshihet në Miniprojektin e vënies në skenë të pjesës dramatike.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Vilhelm Teli (Fragment)**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për dramën.
- Diskutohet nëse kanë parë dramë në teatër apo nëse ata vetë kanë qenë pjesë e ndonjë realizimi skenik.
- Bëhet ndarja e nxënësve sipas roleve për ta lexuar fragmentin.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *dramë, aksion dramatik, kurajë, zotësi, provë, sukses etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë personazhet e kësaj pjese dramatike?

Përgjigje 1:

Personazhet e kësaj pjese dramatike janë:

Vilhem Teli, Valteri (i biri i Vilhelm Telit), Frishardi dhe Leutoldi (roje), Gesleri, Shtaufaheri, Valter Fyrsti, Melhtali, Berta, Rudolf Der Harrasi, Gratë, Roselmani.

2. Cilat nga personazhet janë kundër Vilhelm Telit? Po ata që i dalin në mbrojtje atij?

Përgjigje 2:

Personazhet kundër Vilhelm Telit janë: Gesleri, Frishardi, Leutoldi.

Personazhet që i dalin në mbrojtje të Vilhelm Telit janë: Valteri, Valter Fyrsti, Melhtali, Berta.

3. Për çfarë arsye qëndron kësula në një vend publik?

Përgjigje 3:

Kësula qëndron në një vend publik për arsye që kushdo nga populli që përballet me kësulën, të jetë i detyruar ta nderojë atë, si një formë nënshtrimi ndaj sundimtarit pushtues.

4. Përse Frishardi dhe Leutoldi kërkojnë ta arrestojnë Vilhelm Telin? Çfarë ka bërë gabim ai sipas tyre?

Përgjigje 4:

Sipas rojeve, Vilhelm Teli ka kryer një krim të rëndë duke mos iu përkulur kësulës së vendosur në një vend publik, sepse rregulli ishte që të gjithë qytetarët duhej t'i përkuleshin kësulës kur kalonin përpara saj.

5. Çfarë i kërkon Gesleri Vilhelm Telit që të bëjë si dënim që nuk iu përkul kësulës?

Përgjigje 5:

Gesleri, duke njohur aftësitë e jashtëzakonshme të Vilhelm Telit si harkëtar, i kërkon këtij të fundit, që si dënim pse nuk iu përkul kësulës, të gjuajë me harkun e tij një kokërr mollë e cila do të vendosej mbi kokën e të birit të Vilhelm Telit, Valterit.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

6. Si ju duket dënimi që Gesleri i jep Vilhelm Telit:

- a) i drejtë
- b) i padrejtë
- c) mizor

Argumento.

7. Si e përjeton Vilhelm Teli faktin që është i detyruar që të qëllojë me hark mbi kokën e të birit? Gjej në tekst pjesën që flet për dhimbjen e tij prej prindi që i duhet të rrezikojë jetën e të birit veç për të kënaqur dëshirën mizore të Geslerit.

8. Po sjellja dhe qëndrimi i Geslerit, i cili jep urdhërin për të qëlluar mbi kokën e të birit të Vilhelm Telit, si ju duket:

- a) e padrejtë
- b) e ftohtë
- c) cinike (mospërfillëse, përbuzëse, e vrazhdë)
- d) të gjitha alternativat e mësipërme

(Arsyetoni mendimin tuaj.)

9. Si do ta vlerësonit sjelljen e Valterit: A ka ai frikë nga ajo që pritet të ndodhë apo ka besim të plotë të aftësitë e të atit?

10. Gjeni në tekst dhe rilexoni edhe një herë pjesën që tregon sesi Valteri e pret vendimin e Geslerit që i ati, Vilhelm Teli, të qëllojë me hark mollën mbi kokën e tij, njëqind hapa larg.

Nëse do ta përshkruanit vetëm me një fjalë karakterin dhe qëndrimin e Valterit, cila do të ishte fjala e parë që ju vjen ndërmend për të:

Valteri për mua ishte...

Gjuha e tekstit

Drama, është gjini e letërsisë, në poezi ose në prozë e krijuar për t'u vënë/luajtur në skenë përmes lojës së aktorëve të cilët "veshin" karakteristikat, ndjenjat, emocionet dhe dilemat e personazheve që marrin përsipër të luajnë.

Drama ka zakonisht një konflikt midis personazheve të ndryshme. Ky lloj konflikt zakonisht shprehet përmes **dialogut dramatik**.

Popullore

FJALA E HIDHUR S'HARROHET

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Fjala e hidhur s'harrohet

Autori i pjesës së përzgjedhur: Popullore

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë për përrallën të zgjedhura nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, letërsi popullore

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Dallon krijimtarinë popullore

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë personazhet si edhe mesazhin e përrallës, të diskutojë rreth çështjeve që ngrihen në rubrikat TË KUPTOJMË TEKSTIN, të punojë individualisht dhe të dalë në përfundime vetjake në rubrikat TË ANALIZOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN, GJUHA E TEKSTIT

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Fjala e hidhur s'harrohet**

- Pyeten nxënësit për përrallat që kanë lexuar dhe mbajnë mend.
- Diskutohet për disa karakteristika të përrallës në përgjithësi.
- Bëhet leximi i përrallës nga një prej nxënësve .
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyç: *ndihmë, mosmirënjohje, fjalë e rëndë etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë personazhet e kësaj përralle?

Përgjigje 1:

Personazhet e kësaj përralle janë: burri i varfër dhe luani (gruaja dhe fëmijët e burrit të varfër përmenden si personazhe, por janë personazhe që nuk marrin pjesë në veprim dhe nuk janë shumë aktive).

2. Përse burri shkoi që ta hante luani? A ndodhi ajo që priste burri?

Përgjigje 2:

Burri shkoi që ta hante luani sepse ai (burri) ishte shumë i varfër. Jo, ajo që burri priste të ndodhte, nuk ndodhi sepse luani nuk e hëngri.

3. Si iu përgjigj luani burrit? Çfarë i kërkoi ai burrit në këmbim që ta ndihmonte?

Përgjigje 3:

Luani i tha burrit të varfër se jo vetëm që nuk do ta hante, por madje do ta ndihmonte t'i shpëtonte varfërisë. E vetmja gjë që luani kërkonte në këmbim nga burri ishte që sa herë burri të shkonte për ta takuar luanin, t'i çonte atij nga një kokë dashi.

4. Çfarë i çoi burri luanit kur shkoi ta vizitonte për herën e dytë?

Përgjigje 4:

Burri, kur shkoi ta vizitonte për herën e dytë luanin, i çoi kokën e dashit që luani i kishte kërkuar në këmbim të ndihmës që i dha për t'i shpëtuar varfërisë.

5. Përse burri i thotë luanit "Oh, të marrtë nëma!?" Po luani si u soll pasi dëgjoi burrin duke folur në këtë mënyrë?

Përgjigje 5:

Burri e nëm luanin sepse këtij të fundit (luanit) i vinte goja erë e keqe ndërkohë që ishte shtrirë në prehrin e burrit, për të fjetur.

Luanit edhe pse e kishte dëgjuar burrin që ta nëmte, u soll sikur nuk kishte dëgjuar gjë.

6. Çfarë i kërkoi luani burrit që të bëjë pasi zgjohet nga gjumi dhe hiqet sikur nuk ka dëgjuar?

Përgjigje 6:

Luanit, pasi zgjohet nga gjumi dhe hiqet sikur nuk e ka dëgjuar burrin duke e nëmur, i kërkoi burrit që kur ai (burri) të vinte herën tjetër për ta takuar, t'i sillte një sëpatë latoshe të mprehtë.

Hapi III.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

7. Si ju duket fakti që burri i varfër, si zgjidhje për problemet e tij mendoi të shkonte që ta hante luanin? Mendoni se kjo është mënyra e duhur për t'u përballër me problemet e jetës?
8. Po për sjelljen e burrit i cili e nëm luanin për shkak se i mban goja erë të keqe, edhe pse luani e nxori nga varfëria e skajshme ku ai dhe familja e tij ishin, si ju duket?
9. Cila ishte më e rëndë për luanin, dhimbja fizike që do t'i shkaktonte goditja me sëpatë apo fjala e rëndë dhe e hidhur e burrit? Argumentoni përgjigjen tuaj.
10. Si çdo përrallë, edhe kjo që lexuam në këtë mësim, pavarësisht se flet për një botë fantastike, me personazhe njerëz të cilët flasin dhe komunikojnë lirisht me kafshët, përralla ka si qëllim përfundimtar t'i drejtohet botës së njerëzve dhe t'u lërë atyre një porosi. Cila është porosia apo morali i kësaj përralle? Cila është ajo cilësi që njeriu nuk duhet ta humbasë kurrë përballë dikujt që e ndihmon? Diskutoni për këtë në klasë.

Gjuha e tekstit

Përralla është tregim i shkurtër në prozë, shpesh me përmbajtje fantastike, një nga nënlojet më të njohura e më të përhapura të letërsisë gojore. Përrallat janë trashëgimi e të gjithë popujve, që në kohërat më të vjetra, ato pasqyrojnë botëkuptimin, tiparet e veçanta të çdo kombi, mënyrën e jetesës dhe zakonet.

SHËNIME:

PROJEKT

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Tema mësimore: PROJEKT

Titulli i projektit: Miqtë e mi të veçantë

Kohëzgjatja e realizimit të projektit: Një muaj

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë të gjetura nga vetë nxënësit, në bashkëpunim me mësime të tjerë.

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim, sociologji, menaxhim burimesh dhe të ardhurash.

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Kërkim dhe përzgjedhje informacioni, punë në grup, sipërmarrje e një detyre, hartim dhe zbatim i një ideje, rritje e bashkëveprimit social.

Rezultatet e arritura: Nxënësi/ nxënësja është në gjendje të përfshihet në sipërmarrjen e një projekti duke u bërë pjesë aktive e tij. Ai/ajo jep mendime për realizimin e fazave të projektit, merr përsipër të luajë një rol të caktuar në procesin e organizimit të punës, kupton përgjegjësitë dhe detyrat që i takojnë dhe bashkëpunon me të tjerët për realizimin e ideve.

Hapi I:

Fillimisht nxënësve u sqarohet përmbajtja dhe natyra e projektit. U kërkohet të bëjnë pyetje lidhur me ndonjë paqartësi të mundshme nga ana e tyre.

Më tej, si pjesë e hapit të parë njoftohen se do të kryejnë një vizitë në një nga institucionet e specializuara në edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjatë vizitës, nxënësit mund të bisedojnë me drejtuesit e institucionit dhe të mbajnë shënime në një fletore për çështje si p.sh. numri i fëmijëve që mësojnë në këto institucione, mosha, nevojat e veçanta të gjithsecilit, nxënësit mund të flasin vetë me fëmijët për të zbuluar ëndrrat dhe dëshirat e tyre, të cilat më vonë mund t'i shfrytëzojnë për të ndërtuar një plan pune për t'i ndihmuar ata.

Me ndihmën e mësuesit nxënësit krijojnë një grup pune, ku të ndajnë detyrat.

Hapi II.

Nxënësit ndihmohen dhe udhëzohen që të ngrenë një arkë fondesh në shkollën e tyre në të cilën të gjithë nxënësit mund të kontribuojnë dhe shuma e mbledhur e të ardhurave të shkojë për të ndihmuar fëmijët me nevoja të veçanta.

Hapi III

Nxënësit udhëzohen sesi mund të organizojnë një "panair" të vogël, në ndihmë të mbledhjes së fondeve në shkollën e tyre, ku gjithsecili prej nxënësve që ka një talent në pikturë, punime artistike apo një aftësi tjetër mund ta ekspozojë atë për nxënësit e tjerë dhe për prindërit e nxënësve të cilët mund të marrin pjesë në këtë organizim, për të dhënë mbështetjen e tyre për këtë nismë.

Hapi IV

Pjesë e kësaj nisme mund të jetë edhe interesimi i nxënësve, së bashku me mësuesin/mësuesen e tyre nëpër biznese të ndryshme me qëllim për të kërkuar mbështetjen e tyre me veshje të ndryshme apo lodra, të cilat mblidhen prej nxënësve, do të pakëtohen dhe, në fund, do t' u dërgohen fëmijëve me nevoja të veçanta gjatë periudhës së festave të fundvitit.

Hapi V

Në fund, nxënësit udhëzohen të ndërtojnë një album fotografik të të gjitha etapave të këtij projekti dhe ta vendosin atë në këndin e klasës së tyre. Nëse ndokush prej nxënësve, emocionet e kësaj përvoje, i ka shprehur përmes ndonjë krijimi letrar apo përmes një pikturë, pjesë muzikore etj., mund ta paraqesë krijimin e vet para klasës.

Faik Konica

MALLI I ATDHEUT

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Malli i Atdheut

Autori i pjesës së përzgjedhur: Faik Konica

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, dëgjim, interpretoim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e prozës poetike

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje ta dallojë prozën poetike si një lloj i veçantë shkrimi letrar dhe ta analizojë atë.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Malli i Atdheut**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për prozën poetike.
- Shpjegohet tema dhe disa karakteristika krijuese të Konicës, si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga mësuesi/ja.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *atdhe, mall, mërgim, prozë poetike, etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Kjo prozë poetike e Konicës, edhe pse e shkurtër në vëllim, është mjaft e fuqishme për të treguar lidhjen e fortë që ka njeriu me atdheun e vet. Duke iu referuar pjesës së lexuar më sipër, a mendon autori që njeriu mund ta harrojë ndonjëherë atdheun e vet? Po ju si mendoni?

Përgjigje 1:

Kjo lloj pyetjeje nuk është pyetje kategorike, se cilës mund t'i përgjigjesh thjesht me "po" ose me "jo". Kjo është një pyetje retorike, e cila kërkon që nxënësi të ketë mundësi të japë një mendim të pavarur sipas opinionit vetjak, pasi ka lexuar prozën poetike të Konicës, për lidhjen e njeriut me atdheun e vet.

2. "Malli i atdheut" tregon në mënyrë mjaft të përmbledhur proceset shpirtërore që ndodhin te njeriu kur largohet nga vendi i lindjes, duke nisur nga çastet e fillimit të largimit kur malli duket se nuk do zërë vend në zemrën e njeriut dhe deri në pikën kur dalëngadalë ky mall bëhet i pandashëm nga e përditshmja e atij që është larguar. A jeni dakord që ky proces ndodh te të gjithë njësoj apo mund të ndodhë edhe e kundërta e tij? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Përgjigje 1:

Ashtu si edhe në rastin e pyetjes 1, edhe pyetja 2 i ofron nxënësit mundësinë që të përgjigjet duke e arsyetuar përgjigjen sipas mendimit që ai ka krijuar pas leximit të prozës poetike të Konicës.

Hapi III.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

3. Si e interpretoni ju shprehjen *"kujtimi i kombit, që, me gjithë ca të liga që ka, është kombi ynë"*? Mos vallë autori kërkon të na thotë që ta duam vendin tonë dhe të mos e harrojmë kur largohemi, pavarësisht vështirësive që ai ka? A mendoni edhe ju njësoj me autorin? Pse po/jo?
4. Sipas autorit, kur është çasti kur ndihet më i fortë malli për atdheun?
5. Fillimisht autori e nis rrëfimin në vetën e tretë njëjës (**ai/ajo**): ai thotë *"kur vete njeriu...larg atdheut"*; pastaj autori kalon vetën e dytë njëjës (**ti**): *S'di ç'të mungon, s'di se ç'të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fytyrën...*; në fund kalon në vetën e parë shumës (**ne**): *"kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm, ku qajtëm foshnja e ku lozëm djem"*, dhe vijon me këtë vetë deri në fund të esesë. Përse mendoni ju se autori ka bërë një zgjedhje të tillë, duke shkuar nga veta e tretë në vetën e parë dhe nga njëjësi në shumës? Mos ndoshta kjo është një strategji nga ana e autorit për ta përfshirë sa më shumë edhe lexuesin në këtë atmosferë malli? Kërkoni edhe ndihmën e mësuesit/mësueses për ta analizuar këtë element të teknikës tekstore dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Provoni edhe ju të shkruani një ese me titull "Atdheu im".

SHËNIME:

Din Mehmeti

MËRGIMI

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Mërgimi

Autori i pjesës së përzgjedhur: Din Mehmeti

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e figurave letrare

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poezinë, të gjejë temën, motivin dhe figurat letrare

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Mërgimi**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për autorin.
- Bëhet një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi i poezisë nga mësuesi/ja.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *mërgim, atdhe, mall, rikthim, kujtesë*.

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë sjellin me vete mërgimtarët kur kthehen në atdhe?

Përgjigje 1:

Në vargjet:

"Sjellin makina bujqësore,

Televizorë e lavatriçe

Çdo gjë që ka Evropa tepër,

Autori flet për të mirat materiale që mërgimtarët sjellin me vete kur kthehen në atdhe.

- Po lidhur me zhvillimin e infrastrukturës së vendit të tyre, çfarë sjellin ata?

Përgjigje 2:

Në vargjet:

Sjellin rrugët e drejta,

Sheshe e bulevardet,

Autori flet jo thjesht për rrugët, sheshet apo bulevardet, në kuptimin e parë të fjalëve, por ai është duke folur në kuptimin figurativ, për faktin sesi mërgimtarët, përmes të ardhurave monetare që sjellin, ata nuk ndihmojnë vetëm familjet e tyre, por kontribuojnë në zhvillimin infrastrukturor të atdheut të tyre.

- Përse mërgimtarët "*i mbushin kasetat me këngë popullore*" kur kthehen në atdhe? Çfarë përpiqen të ruajnë ata në këtë mënyrë?

Përgjigje 3:

Mërgimtarët i mbushin kasetat me këngë popullore kur kthehen në atdhe për të ruajtur kulturën dhe kujtimet që i lidhin me ato këngë, në çastin kur të rikthehen përsëri në vendet ku kanë emigruar.

4. Çfarë incizojnë dhe çfarë objektësh blejnë mërgimtarët përpara se të largohen përsëri nga vendi i tyre? Përse i bëjnë ata këto veprime?

Përgjigje 4:

Në vargjet:

Incizojnë zërat e fëmijëve,

Porositë e nënave.

Blejnë plisa të bardhë,

Sharki e çifteli

Dhe para se të kthehen,

Autori i përmend këto veprime që mërgimtarët bëjnë përpara se të kthehen në vendet ku kanë emigruar, si shenjë e përpjekjeve që ata bëjnë për të mos harruar origjinën e tyre.

5. Cila është gjëja më e rëndësishme që mërgimtarët marrin me vete në zemrën e tyre?

Përgjigje 5:

Në vargjet:

I mbushin xhepat e zemrave

Me dhé Kosove

Për ta hedhur në fytyrë

Ditën e fundit,

Autori, përmes metaforës “xhepat e zemrave” dhe të gjithë imazhit poetik të këtyre katër vargjeve të fundit të poezisë, pasi ka përmendur çdo gjë që është e rëndësishme për mërgimtarët, në fund ka lënë gjënë më të rëndësishme, dheun amë, si metaforën më të fuqishme të poezisë, në të cilën bëhen bashkë të gjitha imazhet e mësipërme të kësaj poezie, pasi fjala dhé ka kuptim të thellë polisemik, si truall, si prejardhje, si qëndresë, vazhdimësi dhe, në fund, si stacioni final i gjithkujt.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

6. Si mendoni, dukuria e emigracionit sjell pasoja:

- a) pozitive
- b) negative
- c) të dyja bashkë

(Rrethoni shkronjën para përgjigjes që keni zgjedhur dhe argumentoni zgjedhjen tuaj.)

7. Cila pjesë e poezisë është më e dhimbshme për ju kur e lexoni? Pse?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Shkruajini një letër një shoku apo të afërmi tuaj i cili është në mërgim dhe për të cilin ju ka marrë malli që ta takoni?

Lasgush Poradeci

MËNGJES

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: "Mëngjes"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Lasgush Poradeci

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Dallon stilin poetik të Poradecit

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poezinë, të gjejë figurat letrare, të dallojë stilin poetik të Poradecit.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Mëngjes**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për poezinë e L. Poradecit.
- Shpjegohen disa karakteristika krijuese të Poradecit si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi i poezisë nga mësuesi/ja.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *poezi lirike, peizazh, liqen etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Si janë ndjesitë e poetit përballë çastit të agimit?

Përgjigje 1:

Poeti është i magjepsur duke parë çastin e agimit të ditës.

Agimi për të nuk është thjesht një moment i zakonshëm i kalimit nga nata në ditë, por për të ky kalim është një proces që i ngjall emocione të forta.

Ai vëzhgon gjithçka që shoqëron agun, përmes një përjetimi të thellë.

2. Po përjetimet tuaja kur lexoni një poezi të tillë, si janë?

Përgjigje 2:

Kjo pyetje i jep mundësinë nxënësit që të përgjigjet, duke dhënë përvojën dhe përjetimin e vet për agimin e ditës, pasi ka lexuar poezinë e Poradecit dhe është njohur me përjetimet e thella të poetit.

3. Cilit vendi (qyteti) i kushtohet kjo poezi?

Përgjigje 3:

Duke u nisur nga fakti që kjo poezi është e shkruar nga L. Poradeci, i cili gjatë gjithë jetës së tij, krijoi për qytetin e tij, Pogradecin, edhe kjo poezi i kushtohet po këtij qyteti, edhe pse emri i qytetit nuk përmendet në mënyrë të hapur.

Një argument tjetër që e përforcon faktin që qyteti është Pogradeci, vjen prej përdorimit në poezi të fjalëve çelës si “liqer” dhe “nosit”, të cilat përsëri të adresojnë te ky qytet.

4. Gjeni autorë të tjerë që i kanë kushtuar poezi mëngjesit dhe lexojini ato, për të parë sesi nga një autor te tjetri e njëjta temë poetike trajtohet në mënyra të ndryshme. Një sugjerim është “Zani i nades”, nga Ndre Mjedja. Përpiquni të sillni edhe ju sugjerimet tuaja.

Përgjigje 4:

Kjo pyetje është e ndërtuar si një lloj detyre e vogël, për ta drejtuar nxënësin kah aftësimi për të kërkuar literaturë kur ajo i kërkohet. Sugjerimi i dhënë, është një ndihmë për nxënësin në mënyrë që ai ta gjejë, lexojë dhe të krahasojë dy poezi me tematikë të njëjtë, por nga autorë të ndryshëm.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

5. Çfarë mendoni lidhur me ndjeshmërinë e poetit? A është ajo mjaft e lartë? Pse?
6. Keni vërejtur ndonjëherë edhe ju me vëmendje, ashtu si poeti L. Poradeci, ardhjen e mëngjesit ose zbritjen e natës? Çfarë ndryshimesh ndodhin në botën përreth teje në ato çaste? Çfarë ndodh me format e objekteve, ndriçimin, me ngjyrat, tingujt dhe me gjendjen emocionale të njerëzve?
7. Lasgush Poradeci krijon një poezi kaq të bukur dhe e përshkruan ardhjen e mëngjesit sikur ajo të ishte diçka e jashtëzakonshme dhe magjike? Mendoni se edhe përreth nesh ka gjëra mjaft të veçanta dhe të bukura për t’u parë, por duhet vetëm vëmendja jonë për t’i vërejtur me kujdes? Sillni shembuj.

Gjuha e tekstit

8. Gjeni rastet kur është përdoruar anafora (përsëritja e të fjalëve apo tingujve në fillim të çdo vargu) në këtë poezi. Sa raste anaforash ka? Shkruajini ato:
9. Çfarë lloj rime ka kjo poezi (shikoni me vëmendje rrokjet në fund të vargjeve për të dalluar se rrokja e cilit varg është e ngjashme rrokjen e vargut tjetër):
- a) AABB (rimë e puthur)
 - b) ABAB (rimë e alternuar)
 - c) ABBA (rimë e kryqëzuar/e mbyllur)
- (Qarkoni shkronjën para përgjigjes së saktë.)
10. Poeti flet për natën që ikën me fjalët:
- Po shuhet nata me-nga-dale.*
E shoh ku vdes e ku po vuan,
E syt’ e saj dyke pulitur;

Nata përshkruhet sikur të ishte një organizëm i gjallë e cila “po vuan” dhe po “vdes, pra një dukurie po i vishen tipare frymorësh, duke e shpirtëzuar. Çfarë figure letrare ka përdorur poeti në këtë rast? Arsyeto.

SHËNIME:

Ismail Kadare

NJË MBRËMJE NË LURË

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Një mbrëmje në Lurë

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ismail Kadare

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë për Kadarenë dhe reportazhin të zgjedhura nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, etnografi, gazetari

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, dëgjim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Dallon gjininë e reportazhit si gjini gazetareske

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë gjininë e reportazhit, dhe të bëjë vetë një të tillë.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Një mbrëmje në Lurë**

- a) Pyeten nxënësit, nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për reportazhin.
- b) Shpjegohen disa karakteristika krijuese të Kadaresë si dhe një sqarim i përgjithshëm për reportazhin.
- c) Bëhet leximi nga një prej nxënësve.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *reportazh, përshkrim, analizë, peizazh, kullë etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë karakteristikat që, sipas reportazhit që lexuat, e bëjnë Lurën kaq të veçantë si vend?

Përgjigje 1:

Sipas reportazhit Lura ka pesë liqene magjike, ka një peizazh mjaft të bukur, të mbushur me pyje si dhe nuk lihen pa përmendur kullat karakteristike të malësorëve.

2. Si përshkruhen vendasit e Lurës? Si është sjellja e tyre me aksionistët?

Përgjigje 2:

Vendasit e Lurës përshëndesin këdo me përzemërsi, Ata janë mikpritës dhe të dashur me aksionistët si dhe me udhëtarët në përgjithësi.

3. Çfarë aktivitete kryenin aksionistët pas pune?

Përgjigje 3:

Pas pune, aksionistët sodisin peizazhin dhe atmosferën që krijohet pas darke, nga tingujt e muzikës.

4. Çfarë elementi të veçantë dhe dallues kishin kullat e malësorëve? Përse shërbenin frëngjitë?

Përgjigje 4:

Dritëro Agolli

LEJLEKU

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Lejleku

Autori i pjesës së përzgjedhur: Dritëro Agolli

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë poezie

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poezinë dhe të gjejë figurat letrare.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Lejleku**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për poezinë e Agollit.
- Diskutohet për poezinë e D. Agollit.
- Bëhet leximi i poezisë nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *zog shtegtar, fole, prag, shtëpi, emigrim, breza etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Poezia "Lejleku" i referohet së tashmes apo flet për një kohë të shkuar?

Përgjigje 1:

Poezia "Lejleku" i referohet së shkuarës. Kur autori thotë "Më vjen në mendje një shtëpi", ky varg të çon në kohën e një të shkuare të largët; gjithashtu, foljet në poezi janë në të shkuarën.

2. Kur e ngriti folenë e vet lejleku? Në cilën pemë?

Përgjigje 2:

Në vargjet

"Askush folenë s'e mban mend

Që kur në plep kish zënë vend",

Mësojmë që foleja e lejlekut është ngritur nga lejleku në një kohë të hershme, ndoshta në rini ose edhe në fëmijëri të autorit. Foleja është ngritur në një plep.

3. Në cilën periudhë të vitit kthehej lejleku dhe pasardhësit te foleja?

Përgjigje 3:

Në vargjet,

Dhe mars për mars dhe mot për mot

I bënë çerdhes një remont,

Tregohet periudha në të cilën kthehej lejleku te foleja, e cila është periudha e pranverës.
4. A ka mundur dot ta harrojë "mikun" e tij të vjetër poeti?

Përgjigje 4:

Jo poeti, ka të lidhur shumë kujtime me "mikun", lejlekun dhe nuk e ka harruar asnjëherë atë.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

5. Kur poeti thotë "**Më vjen në mendje një shtëpi**" qysh në fillim të poezisë, ju si e mendoni moshën e tij? Ka kaluar pak kohë nga çasti që po kujton poeti apo ndoshta ky varg nënkupton që kanë kaluar shumë vite?

Si do të ndryshonte kuptimi i këtij vargu nëse poeti thjesht do të shkruante p.sh. "**më kujtohet një shtëpi**"? Mendoni se në këtë rast do të jepej më bukur poetikisht distanca e madhe kohore prej nga ligjëron poeti?

Duke u nisur nga ky rast, diskutoni në klasë për faktin që në poezi nuancat kuptimore janë shumë të rëndësishme. Kërkoni dhe ndihmën e mësuesit/mësueses lidhur me këtë diskutim.

6. Kjo poezi flet për një zog shtegtar siç është lejleku dhe në të gjenden mjaft fjalë që në analizën e poezisë quhen **fjalë çelësa** që ne si lexues na shërbejnë për të zbërthyer më mirë kuptimin e figurshëm që ajo mbart, pra aspektin e saj metaforik. Më poshtë po japim disa prej tyre: *çerdhe, fole, pleqëri, gjenerata, harruan, prag, mërgim.*

Mendoni që këto fjalë kanë lidhje me botën e krijësave shtazore apo me atë njerëzore?

Pra, pavarësisht se poezia është për lejlekun, a mund të themi se brenda saj autori kërkon t'i drejtohet edhe botës njerëzore?

Argumentoni përgjigjet tuaja.

Gjuha e tekstit

Tingullimitimi ose Onomatopeja është përshkrimi i sendeve ose i fenomeneve, duke shfrytëzuar tingullin e posaçëm që kanë disa fjalë të cilat janë të ndërtuara me tinguj të përafërt me tingujt që lëshon njo qenie, një send, një dukuri etj. Në gjuhën shqipe shumë fjalë kanë një përbërje tingullore, që duket sikur përputhet me vetë natyrën e sendit ose të dukurisë si p.sh.: *bubullimë, pëshpëritje, ushtimë, kakarisje etj.* Onomatopetë zgjidhen prej shkrimtarëve sidomos në poezi për të krijuar efekte tingullore që e bëjnë poezinë më melodike.

7. Poezia "Lejleku" është e shkruar me strofa dyvargëshe të cilat quhen **distik**, përveç strofës së fundit e cila përbëhet prej katër vargjesh dhe e cila quhet katrenë.

Gjeni raste të tjera poezish të cilat janë të ndërtuara me distik dhe me **katrenë**.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Keni apo keni pasur kafshë shtëpiake të cilën e doni/e keni dashur dhe me të cilën kaloni/keni kaluar kohë të bukur; ose nëse nuk keni, cila do të ishte një kafshë apo shpend të cilën e pëlqeni dhe që do të donit ta kishit dhe të kujdeseshit për të? Bëni një hartim lidhur me këtë gjë.

SHËNIME:

Gjergj Zheji

POETI I VOGËL

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Poeti i vogël

Autori i pjesës së përzgjedhur: Gjergj Zheji

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, interpretim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë poezie, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të analizojë tregimin, dallon motivet e sjelljes së personazheve letrare.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Poeti i vogël**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për temën, veprën apo autorin.
- Shpjegohet tema dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga mësuesi/ja ose nga një prej nxënësve i pjesës së leximit.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *poeti i vogël, nxënës, mësues, kurajoz, etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë personazhet e këtij tregimi?

Përgjigje 1:

Personazhet e këtij tregimi janë mësuesi dhe poeti i vogël, nxënësi i tij.

2. Kush e rrëfen ngjarjen?

Përgjigje 2:

Ngjarjen e rrëfen mësuesi.

3. Përse e priste nxënësi mësuesin te porta e shkollës? Çfarë i jep ai mësuesit kur e takon?

Përgjigje 3:

Nxënësi e priste mësuesin te porta e shkollës, sepse dëshironte ta takonte që t'i jepte një krijim të vetin.

4. Përse poezia që kishte shkruar nxënësi i vogël ishte e ndryshme nga ajo e bashkëmohatarëve të tij?

Përgjigje 4:

Poezia që kishte shkruar nxënësi i vogël ishte një poezi për atdheun, por ajo ishte e ndryshme nga krijimet e bashkëmohatarëve të tij, sepse nuk ishte e ndërtuar me fjalë të fryra, por me vargje të ngrohta dhe të thjeshta.

5. Përse një ditë nxënësi nuk u shfaq më në shkollë? Çfarë i kishte ndodhur atij?

Përgjigje 5:

Një ditë nxënësi nuk u shfaq më në shkollë, sepse ai ishte shtruar në spital.

6. Çfarë i jep nxënësi mësuesit kur ky shkon ta takojë në spital?

Përgjigje 6:

Nxënësi mësuesit i jep fillimisht një portokall dhe pastaj i jep dy vjersha që kishte krijuar: "Këngët tona" dhe "Deti e portokallat".

7. Po pasi del nga spitali, çfarë i sjell ai mësuesit?

Përgjigje 7:

Pasi del nga spitali, ai mësuesit i sjell një fletore plot me vjersha.

8. Çfarë ka ndodhur shumë vite më vonë me nxënësin e vogël? Çfarë është bërë ai?

Përgjigje 8:

Shumë vite më vonë nxënësi i vogël u rrit dhe u bë, edhe ai, mësues dhe vazhdoi të shkruante vjersha.

9. Për çfarë është i sigurt mësuesi në fund të tregimit?

Përgjigje 9:

Mësuesi, në fund të tregimit, është i sigurt që, nxënësit që do të ulen në bankat e shkollës, do të kenë në librat e leximit edhe vjershat e nxënësit të tij të dikurshëm.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

10. Gjej në tekst fragmentin ku mësuesi flet për temat për të cilat shkruante poeti i vogël. Cilat ishin ato?
11. Si e vlerësoni ju marrëdhënien mes nxënësit dhe mësuesit në këtë tregim?
12. Çfarë e habit mësuesin kur shkon ta takojë nxënësin në spital? Po juve, ju bën përshtypje fakti që poeti ynë i vogël nuk ka frikë nga operacioni?
13. Cila është pjesa që të pëlqen më tepër në këtë tregim? Pse?
14. Në tregimin e mësipërm ka dy momente kur mësuesi bën përshkrimin e poetit të vogël. Herën e parë përshkrimi është fizik ndërsa përshkrimi i dytë është më tepër shpirtëror dhe moral. Gjejini këto fragmente në tekst.

Gjuha e tekstit

15. Tregimi që lexuat në këtë mësim është:

- a) romantik
- b) fantastik
- c) realist

(Qarkoni shkronjën para përgjigjes së saktë dhe sqaroni zgjedhjen tuaj.)

16. Në këtë tregim janë përdorur mjaft **epitete**. Gjejini ato në tekst.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Shkruajini një letër mësuesit/mësueses suaj të parapëlqyer ku t'i tregoni se pse e vlerësoni dhe se çfarë ndikimi ka pasur ai/ajo në formimin tuaj si nxënës.

Naim Frashëri

DËSHIRA E VËRTETË E SHQIPTARËVE

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Dëshira e vërtetë e shqiptarëve

Autori i pjesës së përzgjedhur: Naim Frashëri

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë poezie

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poezinë, të gjejë figurat letrare, temën dhe motivin e poezisë.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Dëshira e vërtetë e shqiptarëve**

- Pyeten nxënësit, nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për poezinë: *Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*.
- Diskutohet rreth veprimtarisë letrare dhe kulturore të N. Frashërit.
- Bëhet leximi nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *komb, gjuhë, lashtësi etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrjen e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Çfarë kërkon poeti nga shqiptarët? Cilat janë porositë që ai u lë atyre?

Përgjigje 1:

Poeti nga shqiptarët kërkon që ata të jenë përherë të bashkuar, si vëllezër, në emër të lirisë. Porositë që poeti u lë shqiptarëve janë që përveçse të jenë të bashkuar, të mbrojnë atdheun me çdo kusht dhe çmim.

2. Cilat janë karakteristikat e shqiptarëve për të cilat flet poeti?

Renditini ato më poshtë.

Përgjigje 2:

- trim
- atdhetar
- i urtë (i mençur)
- besnik

Nxënësi mund edhe të shtojë cilësi të tjera që nxjerr nga leximi i tekstit.

3. Naimi i quan shqiptarët "bij të Skënderbeut". Çfarë domethënie ka për ju kjo shprehje? A është ajo vetëm një lavdërim apo edhe një detyrë për ta mbajtur gjithnjë me dinjitet këtë emër?

Përgjigje 3:

Kjo shprehje nuk është thjesht një lavdërim, por ajo është njëkohësisht edhe një porosi dhe madje detyrë që i vihet përpara çdo shqiptari, për të ruajtur identitetin e vet.

Nxënësi mund të ofrojë përgjigje dhe argumente shtesë për këtë ushtrim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/ses, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

4. Si e quan Naimi gjuhën shqipe? Cilat janë epitetet që ai përdor për të karakterizuar atë?

Gjejini ato në tekst dhe shkruajni.

Gjuha shqipe është:

a) e dliirë

b) _____

c) _____

d) _____

5. Cilat janë figurat letrare të përdorura më dendur në këtë poezi?

a) metafora

b) _____

c) _____

d) _____

e) _____

f) _____

Gjuha e tekstit

Retiçenca (heshtja), është ajo figurë letrare e cila konsiston në ndërprerjen e ligjëritimit në një poezi ose prozë, për ta lënë të nënkuptuar atë që autori ka dashur të shprehë. Zakonisht retiçenca dallohet lehtë në një tekst sepse ajo realizohet përmes tri pikave të heshtjes.

Romantik/Romantizmi është lëvizje kulturore dhe artistike që lindi në fund të shekullit XVIII, kryesisht në Angli dhe Gjermani dhe u përhap pastaj në të gjithë Europën. Në vija të përgjithshme romantizmi karakterizohet nga një ndjeshmëri e lartë ndaj botës dhe dukurive njerëzore, një kërkesë për liri në art duke thyer rregullat e ngurta të klasicizmit.

6. Si i kuptoni vargjet e Naimit:

Ne pellazgë kemi lerë para se të lindte hëna

kur Adami nuk ka qënë veçse ujë dhe pluhur

Shpjegojini me fjalët tuaja se cila është domethënia e tyre.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Bëni një hartim me temë "Kombi im" ku të flisni për cilësitë e kombit tuaj sot si dhe ato gjëra që mendoni që kombi juaj duhet të arrijë në të ardhmen.

SHËNIME:

Hajro Ulqinaku

ÇKA FLASIN PULËBARDHAT

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Çka flasin pulëbardhat

Autori i pjesës së përzgjedhur: Hajro Ulqinaku

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të analizojë tregimin, përcakton se në cilën kohë është vendosur ngjarja.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: Çka flasin pulëbardhat

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për H. Ulqinakun.
- Shpjegohen disa karakteristika krijuese të autorit si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi i pjesës nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *pulëbardhat, gjuhë, det, fëmijë etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Ku zhvillohet ngjarja e rrëfyer në këtë tregim?

Përgjigje 1:

Ngjarja e rrëfyer në këtë tregim zhvillohet në mol, në mbrëmje.

2. Si ju duket fillimisht përshkrimi i atmosferës së molit kur kthehen peshkatarët? Po më vonë, si ndryshon kjo atmosferë?

Përgjigje 2:

Fillimisht atmosfera paraqitet e gëzueshme, me pamjen tipike të një qyteti bregdetar. Më pas, sapo rrëfyeni i ngjarjes/autori fillon të meditojë për atë që mund të jenë duke thënë pulëbardhat me gjuhën e tyre të zogjve, për dhimbjen, urinë dhe të gjitha padrejtësitë që ato kanë parë nëpër botë, atmosfera nis të ndryshojë dhe të bëhet e trishtueshme.

3. Çfarë mendon autori se po "flasin" pulëbardhat?

Përgjigje 3:

Autori mendon që, me gjuhën e tyre, pulëbardhat janë duke rrëfyer gjithë fatet e trishtuara të njerëzve, kryesisht të fëmijëve, që ato kanë parë nëpër botë, gjatë fluturimeve të tyre.

4. Cilat janë tri shqetësimet që "rrëfejnë" pulëbardhat përmes këngës së tyre?

Përgjigje 4:

Pulëbardhat thonë se në botë kanë parë shumë fëmijë të uritur, kanë parë fëmijë që nuk dinë të shkruajnë dhe as të lexojnë për shkak se nuk mund të arsimohen si pasojë e varfërisë si dhe kanë parë tragjedinë që shkaktojnë luftërat anembanë botës, duke u rrëmbyer fëmijëve familjet e tyre dhe fëmijërinë.

5. Po tri "dëshirat" që ato shprehin, cilat janë?

Përgjigje 5:

Dëshirat që pulëbardhat shprehin janë që të mos ketë më fëmijë të uritur, që të gjithë fëmijët të kenë mundësinë që të arsimohen dhe që luftërat anembanë botës të ndalen.

6. A pajtohet autori me gjithçka që thonë pulëbardhat?

Përgjigje 6:

Po, autori pajtohet me gjithçka thonë pulëbardhat.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

6. Në shqetësimin e tyre të parë pulëbardhat thonë: "*Piu-piu! Piu-piu! Vijmë nga larg, nga larg. Nëpër këtë botë kemi parë shumë fëmijë të uritur. Ata rrojnë e vdesin nga uria, pse dikush jeton në begati! O, sa mirë do të ishte që të gjithë fëmijët e botës ta kishin barkun plot, të ishin të ngopur!*" - Si ndiheni ju kur lexoni këto rreshta? Është e drejtë që bota të jetë e ndarë në mënyrë kaq të pabarabartë? Diskutoni lidhur me këtë çështje me shokët dhe shoqet tuaja?

7. Në shqetësimin e tyre të dytë pulëbardhat thonë: "*Piu-piu! Çik-çak!*

Në botë ka shumë njerëz të cilët nuk dinë të shkruajnë e të lexojnë. Ka shumë fëmijë të cilët nuk janë shokë me librin, të cilët nuk e kanë parë shkëlqimin e kullës së dritës...

O, sa mirë do të ishte sikur: të gjithë fëmijët e botës të shkojnë në shkollë, të mësojnë, të bëhen mendimtarë!" - Po kur lexoni këto fjalë, si ndiheni? E keni menduar ndonjëherë se ka fëmijë nëpër botë të cilëve e drejta për shkollim u është mohuar dhe ata nuk mundën dot të shkruajnë dhe lexojnë? Ndoshta ata janë të detyruar të punojnë që në moshë të vogël dhe e ëndërrojnë të ulen një ditë në bankat e shkollës dhe të mbajnë në duar një libër të cilin të jenë në gjendje ta lexojnë. Diskutoni në klasë rreth kësaj çështjeje.

8. Në shqetësimin e tyre të tretë pulëbardhat thonë: "*Piu-piu! Çak-çek! Kri-krra!*

Tmerr! Hatá! Trishtim! Kemi parë troje në flakë! Shumë shtëpi, çerdhe fëmijësh digjen në botë. Shumë fëmijë mbeten pa lodra, mbeten pa vëllezër, motra, prindër. Ua rrëmben lufta! Sa e tmerrshme që është lufta! Kurrë luftë në botë mos u bëftë!" - Çfarë ndieni ju për bashkëmoshatarët tuaj nëpër botë të cilët jetojnë në vende ku ka luftë dhe janë vazhdimisht të rrezikuar?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Cilat janë shqetësimet tuaja si nxënës i klasës së shtatë lidhur me çfarë ndodh përreth jush?

Jeni të shqetësuar ndoshta për gjendjen e fëmijëve nëpër botë, për rajonet në luftra apo konflikte, ose ndoshta për ndryshimet mjedisore, për zhdukjen e pyjeve, kafshëve apo për ndonjë çështje tjetër? Shkruaj një hartim me temë "Bota që unë dua".

SHËNIME:

PROJEKT

GJURMËT HISTORIKE TË VENDIT TIM

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Tema mësimore: PROJEKT

Titulli i projektit : Gjurmët historike të vendit tim

Kohëzgjatja e realizimit të projektit : Një muaj

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë të gjetura nga vetë nxënësit, në bashkëpunim me mësuesin/mësuesen.

Lidhja me fushat e tjera: Histori, gjuhë dhe komunikim, etnokulturë, sociologji, menaxhim informacioni.

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Kërkim dhe përzgjedhje informacioni, punë në grup, sipërmarrje e një detyre, hartim dhe zbatim i një ideje.

Rezultatet e arritura: Nxënësi/Nxënësja njih më mirë aspektet historike, etno-kulturore dhe sociale të vendit të tij/saj. Nxënësi është në gjendje të përfshihet në sipërmarrjen e një projekti duke u bërë pjesë aktive e tij. Ai/ajo jep mendime për realizimin e fazave të projektit, merr përsipër të luajë një rol të caktuar në procesin e organizimit të punës, kupton përgjegjësitë dhe detyrat që i takojnë dhe bashkëpunon me të tjerët për realizimin e ideve.

Hapi I:

Fillimisht nxënësve u prezantohet përmbajtja dhe qëllimi i projektit, i cili është që nxënësit të familjarizohen sa më shumë me aspektin historik të qytetit apo trevës ku ata jetojnë. U kërkohet të bëjnë pyetje lidhur me ndonjë paqartësi të mundshme nga ana e tyre.

Më tej, si pjesë e hapit të parë, ata lexojnë pjesën "Kështjella e Ulqinit" të autorit G. Çitaku (*Udhëtim në kështjellat Ilire të Malit të Zi, Ulqini, 2019*), për të krijuar një ide fillestare dhe për të pasur një model paraprak pune.

Me ndihmën e mësuesit, nxënësit krijojnë një grup pune, ku ndajnë detyrat.

Hapi II.

Pas përmbushjes së hapit të parë, hapi vijues për realizimin e këtij projekti, konsiston në udhëzimin e nxënësve për të lexuar materiale historike që flasin për të shkuarën e vendit të tyre; ata mund të orientohen që të konsultohen me mësuesin/mësuesen e lëndës së historisë si dhe të kërkojnë në internet për informacione dhe kuriozitete të ndryshme lidhur me punën që do të kryejnë.

Hapi III

Pasi të kenë bërë të gjitha konsultimet e duhura me burimet e informacionit, nxënësit udhëzohen të përcaktojnë se cili do të jetë **objekti i tyre i punës**, pra për cilin objekt apo vend historik, do ta zhvillojnë këtë projekt. Objekti mund të jetë ndonjë kala, si në rastin e leximit të mësipërm, mund të jetë ndonjë lokacion i caktuar i cili mund të ketë një të kaluar të shquar për komunitetin ku nxënësit jetojnë, mund të jetë ndonjë ngjarje e rëndësishme, element etno-kulturor etj.

Hapi IV

Hapi tjetër është që, pasi nxënësit të kenë vendosur për çfarë do të punojnë, ata mund të rifillojnë të mbledhin sa më shumë informacion, por duke u përqëndruar në atë që tashmë është objekti i tyre i punës, në mënyrë që ta njohin sa më mirë atë për të cilën do të punojnë.

HAPI V

Mandej, pas mbledhjes së informacionit, nxënësit udhëzohen që të mendojnë për mënyrën sesi do ta paraqesin këtë informacion për audiencën (klasën) e tyre. Për shembull, mund

t'u sugjerohet që që informacionin e mbledhur ta shprehin përmes një eseje, reportazhi, dokumentari të shkurtër, përmes një ekspozite me fotografi, prezantimi në power point, pjese dramatike, pjese koreografike etj.

Përmes konsulencës me mësuesin/mësuesen nxënësi e zgjedh formën e prrezantimit të materialit në varësi të prirjeve të veta artistike.

Për realizimin e këtij projekti nxënësit këshillohen që të hartojnë vetë një plan pune të hollësishëm, në mënyrë që të menaxhojnë sa më mirë kohën edhe burimet që kanë në dispozicion.

SHËNIME:

Ndre Mjedja

TRINA

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Trina

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ndre Mjeda

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë të përzgjedhura nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, interpretim, shkrim krijues

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Interpreton dhe dallon poetikën e Mjedës

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poemën, të gjejë figurat letrare, të dallojë temën, motivin dhe ta interpretojë poemën.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Trina**

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake poezinë e Mjedës.
- b) Diskutohet gjerësisht për krijimtarinë dhe angazhimin intelektual të N. Mjedës.
- c) Bëhet leximi i poemës nga mësuesi/ja.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *ëndërr, mal, Zojë, vdekje etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë personazhet e kësaj poeme?

Përgjigje 1:

Personazhet e kësaj poeme janë Lokja, Trina dhe Zoga.

2. Si është atmosfera dhe mjedisi që përshkruhet në këtë poemë?

Përgjigje 2:

Atmosfera dhe mjedisi që përshkruhet në këtë poemë janë mjaft idilike, me pyje të dendura, me lëndina, blegërima bagëtish dhe natyrë të qetë.

3. Cilat janë figurat mitologjike që përmenden në këtë fragment?

Përgjigje 3:

Figurat mitologjike që përmenden në këtë fragment janë shtojzovallet.

4. Përse është e shqetësuar Zoga për motrën e saj? Çfarë i thotë ajo nënës së saj?

Përgjigje 4:

Zoga është e shqetësuar për të motrën sepse Trina është e sëmurë. Ajo i thotë së ëmës që Trina nuk po zgjohet dot nga gjumi.

5. Po Lokja a është e shqetësuar? Pse? Çfarë po vëren ajo me shqetësim të Trina?

Përgjigje 5:

Lokja është shumë e shqetësuar sepse Trina nuk po ha ushqim dhe duket që ka një problem me shëndetin.

6. Përse Trina nuk u çua prej shtratit në mëngjes?

Përgjigje 6:

Trina nuk u çua prej shtratit në mëngjes, sepse ishte shumë e sëmurë.

7. Përse po vjen prifti dhe dajat me qirinj në duar dhe pse shtëpia është mbushur përplot me njerëz? Çfarë pritet të ndodhë?

Përgjigje 7:

Prifti dhe dajat vijnë me qirinj në duar dhe shtëpia është mbushur përplot me njerëz sepse Trina është në çastet e fundit të jetës.

8. Çfarë i ndodh Trinës?

Përgjigje 8:

Trina ndërron jetë dhe këtë çast autori e shpreh në mënyrë mjaft simbolike përmes fjalëve të Lokes, e cila i thotë Zogës:

- Rri, bij' se sunte Trinka

Po shkon me bujtë te Zoja.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

9. Në strofën e fundit të pjesës së parë të poemës autori shkruan:

Veç prei plehit gjel kokoti,

Me njat za qi s'ndrron kurr-herë,

Ka me gjegjë se â tui ndërrue moti,

Se â tui çue nji tjetrë erë.

Duke marrë parasysh se çfarë ndodh në fund të poemës (faktin që Trina ndërron jetë), mund të themi se dy vargjet e fundit të strofës së cituar më sipër na japin një paralajmërim se diçka ka për të ndodhur?

10. Si ju duket ju qëndrimi i Lokes para faktit që vajza e saj është duke dhënë shpirt? A është ajo në sytë tuaj një grua e fortë e cila po përballon dhimbjen e thellë që po kalon?

11. Lokja i drejtohet Zogës me fjalët:

-Bij', mos e prek, se njomja

Tash â tui folë me Zojen;

Dhe, pak më vonë i thotë:

-Rri, bij' se sunte Trinka

Po shkon me bujtë te Zoja;

Çfarë është duke i thënë, në fakt, Loka Zogës në mënyrë të zbutur, për të mos e tronditur botën e saj feminare? Pse nuk i thotë ajo hapur që Trina është duke ndërruar jetë? Pse zgjedh Lokja këtë mënyrë dhe a mendoni ju se është kjo forma e duhur? Diskutoni në klasë.

Gjuha e tekstit

Gjeni në tekst figurat letrare të përdorura më dendur dhe shkruajini ato:

Metaforat:

Krahasimet:

Migjeni

TË KORRUNAT

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Të korrurat

Autori i pjesës së përzgjedhur: Migjeni

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shpesh nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë letrare

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë poetikën migjeniane, dallon skicën dhe elementet e saj. Diskuton rreth çështjeve që ngrihen në rubrikat TË KUPTOJMË TEKSTIN, të punojë individualisht dhe të dalë në përfundime vetjake në rubrikat TË ANALIZOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN, GJUHA E TEKSTIT si dhe të kryejë në mënyrë të pavarur rubrikën DETYRË.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Të korrurat**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për veprën e Migjenit.
- Shpjegohen disa karakteristika krijuese të poetikës së Migjenit si dhe një sqarim i përgjithshëm për skicën.
- Bëhet leximi nga ndonjë prej nxënësve.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shpesh për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *skicë, fëmijë, luftë, skicë etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Si është atmosfera e fillimit të tregimit?
 - optimiste
 - e trishtë

Përgjigje 1:

Atmosfera e fillimit të tregimit është optimiste, deri në pikën kur mbi arat e mbjella me grurë shfaqen topat e luftës.

2. Po atmosfera e pjesës së dytë të tregimit, në çastin kur fshatarët gjenden përballë fushës së mbjellë me grurë, por që kanë dalë topat e luftës, si ju duket?

Gjeni një apo disa përcaktime për këtë atmosferë?

Ajo është:

- e pashpresë
- e frikshme

- e paqartë se çfarë po ndodh
- dëshpëruese.

Nxënësi mund të ofrojë edhe alternativa të tjera plus, për ta plotësuar përshkrimin e kësaj situatë.

3. Përse u tronditën dhe u trishtuan fshatarët ndërkohë që kishin dalë në arë për të korrur grurin? Çfarë kishte ndodhur?

Përgjigje 3:

Ndërkohë që kishin dalë në arë për të korrur grurin, fshatarët u tronditën dhe u trishtuan, sepse në arat e mbjella me grurë ishin shfaqur topat e luftës dhe ata jo vetëm që nuk mund të korrnin prodhimin e tyre, për shkak të pranisë së topave, por kjo prani e armëve luftarake do të thoshte që lufta po afronte dhe që e ardhmja ishte e zymtë dhe madje e pashpresë.

4. Po reagimi i fëmijëve si ishte kur panë topat e luftës në arat me grurë drejtuar fshatit të tyre?

Përgjigje 4:

Reagimi i fëmijëve, pasi prindërit u thonë “do të mësoheni me ngranë hekur!” ishte i gëzuar.

5. Përse mendoni ju se fëmijët vazhdonin të ishin ende të gëzuar dhe vijonin lojën e tyre pa u shqetësuar se çfarë kishte ndodhur?

Përgjigje 5:

Fëmijët vazhdonin të ishin ende të gëzuar dhe vijonin lojën e tyre pa u shqetësuar se çfarë kishte ndodhur sepse ata, duke mos e kuptuar sesa e rëndë ishte situata, nuk ishin të vetëdijshëm që prindërit po u thoshin se e ardhmja e tyre do të ishte e pasigurt.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

6. Me çfarë ndijesish e mbyllet ju leximin e kësaj pjese?

- a) pozitive
- b) negative

Argumentoni zgjedhjen tuaj.

7. Skica që ju lexuat në këtë mësim flet për realitetin e dhimbshëm të luftës. Edhe pse “Të korrurat” është shkruar shumë vite më parë, ajo ende sot na e kujton që lufta është shkatërruesja e lumturisë njerëzore.

Çfarë dini ju për luftërat që janë bërë apo që edhe bëhen ende sot nëpër botë dhe si ndiheni kur dëgjoni lajme të tilla?

8. A mendoni që fëmijët e përshkruar në këtë tregim/skicë letrare, pavarësisht se janë të vetmit që gëzojnë e luajnë para topave të luftës, do të jenë ata që do t’i vuajnë më tepër pasojat e saj (luftës)? Argumentojeni përgjigjen tuaj.

Gjuha e tekstit

Skica letrare është një tregim i shkurtër, me karakter letrar ose publicistik. Në skica përshkruhen, pa shumë hollësi, ngjarje, njerëz apo dukuri. Në letërsinë shqipe janë mjaft të njohura skicat e Migjenit.

9. Në fillim të këtij tregimi thuhet se dielli “perëndonte i qeshun dhe i kënaqun”.

Si quhet figura letrare e cila u jep cilësi njerëzore sendeve, kafshëve apo dukurive të ndryshme?

- antitezë
- krahasim
- personifikim
- metaforë

(Qarkoni shkronjën para përgjigjes së saktë.)

Ernest Heminguej

PLAKU DHE DETI

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Plaku dhe deti

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ernest Heminguej

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë pjesët përbërëse të fragmentit të shkëputur nga novela "Plaku dhe deti" dhe ta analizojë atë.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Plaku dhe deti**

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për novelën: Plaku dhe deti.
- b) Shpjegohen disa karakteristika krijuese të autorit si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *det, peshk, peshkaqenë, betejë, sakrificë etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruarra për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Nga fragmenti që lexuat, si mendoni që ka qenë lufta e Plakut me peshkun që ka zënë?

Ka qenë e ashpër apo Plaku ka arritur ta zërë peshkun me lehtësi?

Gjeni në tekst ato pjesë që mbështesin mendimin tuaj.

Përgjigje 1:

Lufta e Plakut me peshkun që ka zënë ka qenë mjaft e ashpër dhe e lodhshme.

Plaku ka mundur ta zërë peshkun me mjaft vështirësi.

Nxënësi mund të nënvizojë në tekst pjesët që mbështesin përgjigjet e kësaj pyetje.

P.sh. në fragmentin, kur plaku shprehet se:

"Vetëm kështu mund ta vrisja. Ai e ndjente veten më mirë pasi piu ujë dhe e dinte që nuk do të humbiste ndjenjat dhe kokën e kish të kthjellët."

Si dhe në fragmentin:

"Me siguri i kalon pesë kuintalët, mendoj. Mbase edhe më shumë."

Arrihet në përfundimin se lufta për të zënë një peshk të këtyre përmasave duhet të ketë qenë mjaft e vështirë.

2. Si do ta vlerësonit karakterin e Plakut?

Përgjigje 2:

Karakterin e Plakut është stoik/ i papërkulur dhe njeri me mjaft përvojë. Plaku nuk dorëzohet përpara asnjë situatë dhe gjithnjë gjen mënyrën për t'i mbijetuar rrethanave të vështira.

3. Si është lufta mes Plakut dhe peshkaqenëve? Cila është pjesa që ju duket më emocionuese në këtë fragment? Pse?

Përgjigje 3:

Lufta mes Plakut dhe peshkaqenëve është e pamëshirshme. Të dyja palët luftojnë deri në pikën e fundit, Plaku për të mbrojtur peshkun që ka kapur, ndërsa peshkaqenët për t'ia rrëmbyer peshkun Plakut.

Vijimin e pyetjes 3, ku i kërkohet që të shprehet se cila është pjesa më emocionuese e tregimit për të, nxënësi mund të zgjedhë të përgjigjet sipas opinionit të vet, pasi ka lexuar pjesën.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet të përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

4. I vetëm, i stërlodhur dhe pa asnjë armë, Plaku lufton me mjete rrethimore që i kanë mbetur në barkë dhe me shpirt ndër dhëmbë me peshkaqenët në mënyrë që të mos i lejojë që t'i grabisinin peshkun. Ai e di që kjo luftë është e pabarabartë, sepse peshkaqenët janë shumë dhe ai është i vetëm, por ai gjithsesi vazhdon të luftojë.

Çfarë domethënieje ka kjo luftë e tij për ju? Mos ndoshta ajo do të na thotë që njeriu nuk duhet të dorëzohet asnjëherë, pavarësisht vështirësive që i dalin përpara në jetë? Diskutoni me njëritjetrin në klasë.

Gjuha e tekstit

Novela:

Rrëfim i gjatë, kryesisht në prozë, e cila flet për përvoja të ndryshme njerëzore, përmes një rrëfimi që lidh segmentet e ndryshme të ngjarjes që rrëfëhet.

Novela është më e gjatë se tregimi dhe zakonisht më e shkurtër se romani, megjithëse kufijtë e gjatësisë së tyre nuk janë të përcaktuar.

5. Plaku, gjatë gjithë fragmentit që lexuat, vazhdimisht ose flet me veten ose "bisedon" me peshkun që ka kapur, ose u "hakërrehet" peshkaqenëve që e sulmojnë. Mendoni që kjo ndodh vetëm për shkak se plaku nuk ka njeri me të cilin të bisedojë, apo sepse deti, peshqit apo edhe vetë peshkaqenët që e sulmojnë, ai i ndien sikur të ishin pjesë e pandarë e jetës së tij? Diskutoni në klasë lidhur me këtë çështje.

6. Gjatë "dialogut" me peshkun, në një moment Plaku shpreh keqardhje që e ka vuarë. Ishte vërtet Plaku vetëm një peshkatar i ashpër, i cili thjesht bënte punën e vet duke gjuajtur peshk në det, apo kjo ndjeshmëri tregon anën e butë të peshkatarit?

Gjeni në tekst këtë fragment dhe diskutoni.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Nëse do të kishe mundësi t'i bëje një intervistë imagjinare Plakut të kësaj novele, cilat do të ishin pyetjet që do të dëshiroje t'i bëje? Shkruaj pyetje dhe sqaro se pse i ke zgjedhur ato.

SHËNIME:

Mark Tven

NJË FTESË PËR TOMIN DHE HAKUN

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Një ftesë për Tomin dhe Hakun

Autori i pjesës së përzgjedhur: Mark Tven

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë llojet e rrëfimit

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: Një ftesë për Tomin dhe Hakun

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për veprën apo autorin.
- b) Shpjegohet tema dhe disa karakteristika krijuese të autorit, si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *aventurë, udhëtim, shok, e papritur etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Kush e rrëfen ngjarjen?

Përgjigje 1:

Ngjarjen e rrëfen shoku i Tom Sojerit, Haku Fini.

2. Cilët janë personazhet e tregimit?

Përgjigje 2:

Tom Sojeri, Haku Fini dhe teze Poli janë personazhet kryesore;

Benni, xhaxha Silasi, hallë Selli, Brejs Danlepi dhe Jupiter Danlepi dhe vëllai binjak dhe i humbur i Jupiter Danlepit, Xheku, janë personazhe dytësore, për të cilat tregohet nga teto Poli.

3. Çfarë ftese kanë marrë Tom Sojeri dhe Haku Fini? Kush ia jep atij ftesën?

Përgjigje 3:

Tom Sojeri dhe Haku Fini kanë marrë një ftesë për të shkuar për vizitë te hallë Seli, në Arkansas.

4. Si e pret Tomi ftesën? Përse nuk i gëzohet ai ftesës së marrë? Cili qe plani i tij?

Përgjigje 4:

Tomi fillimisht e refuzon ftesën. Ai hiqet sikur nuk gëzohet që do të shkonin në Arkansas,

sepse kishte frikë mos teze Poli ndërronte mendje që ta lejonte të shkonin, për shkak të merakut se mos djemve u ndodhte gjë rrugës. Ai kishte si plan që ta refuzonte fillimisht ftesën, në mënyrë që teze Poli këtë reagim të tij ta merrte si sfidë ndaj fjalës së saj dhe, në këtë mënyrë, ajo të ishte edhe më e vendosur që t'i lejonte djemtë të shkonin.

5. Çfarë shqetësimi kishin xhaxha Silasi e hallë Selli? Si mund t'i ndihmonin ata Tom Sojeri dhe Haku Fini?

Përgjigje 5:

Xhaxha Silasi e hallë Selli kishin probleme me Jupiter Dnalepin, i cili shqetësonte dhe nervozonte mjaft xhaxha Silasin.

Fragmenti përmend vetëm idenë e teze Polit që djemtë të shkojnë në Arkansas në ndihmë të xhaxha Silasit dhe hallë Selit, por jo se cila do të ishte ndihma konkrete që Tom Sojeri dhe Haku Fini do të jepnin.

Për të nxitur dhe rritur aftësitë mendore te nxënësi, ky i fundit mund t'i përgjigjet pyetjes së dytë të pyetjes 5 duke parashikuar dhe përfytyruar vetë një formë të mundshme ndihme si p.sh. një variant përgjigjeje do të ishte: fakti që dy djemtë e rinj do të shkonin në Arkansas kjo do të bënte që xhaxha Silasi të mos ndihej vetëm përpara sjelljes së Jupiter Danlepit dhe kjo do ta bënte ta përballonte më mirë situatën me të.

6. Kush ishte Brejs Danlepi? Po Jupiter Danlepi? Çfarë karakteristikash kishin ata si njerëz?

Përgjigje 6:

Brejs Danlepi ishte pasaniku më i madh në tërë rrethinat dhe kishte shumë skllëvër. Ai ishte krenar për pasurinë që zotëronte dhe i pëlqente të komandonte.

Jupiter Danlepi ishte i vëllai i Brejs Danlepit. Ai ishte përtac, hileqar, frikacak, por në përgjithësi djalosh zemërmirë.

7. Përse fqinjët bëjnë me faj xhaxha Silasin dhe kanë nisur ta shohin me sy të keq atë?

Përgjigje 7:

Për shkak se nervozohej nga Jupiter Danlepi, xhaxha Silasi, i cili ishte pastor dhe njeri mjaft i qetë, ai kishte filluar të grindej me Jupiterin dhe për këtë arsye ai nuk mund të predikonte siç duhej. Kjo kishte sjellë pasojën tjetër që fqinjët ta bënë xhaxha Silasin me faj dhe kishin nisur ta shihnin me sy të keq.

8. Jepet në tekst se si veproi Tom Sojeri dhe Haku Fini? A u nisën ata për udhëtim?

Përgjigje 8:

Jo, ky fragment nuk e jep vazhdimin e historisë.

Nxënësit mund t'i kërkohet si një detyrë jashtë klase që të lexojë "Aventurat e Tom Sojerit" dhe të gjejë si përfundon kjo histori që fragmenti i shkëputur ka nisur të rrëfejë.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/ses, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

9. Cili do të ishte karakterizimi që do të mund t'i bënit Tom Sojerit nga pikëpamja e karakterit?

A është i zgjuar? Gjeneri në tekst pjesën që e tregon këtë gjë dhe lexojeni.

10. A janë interesante aventurat nëse i bën vetëm? Keni dhe ju ndonjë shok me të cilin bëni aventurat tuaja?

Letërsi për fëmijë, janë ato lloj krijimesh letrare, kryesisht në prozë, (novela, tregime, romane) të cilat përgjithësisht rrëfejën histori ose ngjarje që lidhen me botën e fëmijëve. Letërsia botërore ka mjaft shkrimtarë të cilët kanë krijuar vepra të tilla si Mark Tven "Aventurat e Tom Sojerit", Ferenc Molnar "Djemtë e Rrugës Pal", Michale Ende "Historia pa mbarim", Çarls Dikens "Oliver Tuist", Rudijar Kipling "Libri i xhunglës", Luis Karoll "Liza në botën e çudirave"etj.

DITARI I LEXIMEVE

Ferenc Molnar

DJEMTË E RRUGËS PAL

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Djemtë e Rrugës Pal

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ferenc Molnar

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me vëmendjen e duhur pjesën e romanit dhe ta komentojë atë në klasë

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: Djemtë e Rrugës Pal

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për veprën apo autorin.
- b) Bëhet një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *mësuesi, nxënësit, sekreti, besnikëri, miqësi etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 1. Cilat janë personazhet që janë pjesë e këtij tregimi?
 2. Çfarë kanë krijuar së bashku djemtë e Rrugës Pal?
 3. Cili ishte "simboli" që djemtë e Rrugës Pal kishin për "klubin" e tyre?
 4. Si ishte e ndërtuar "struktura" e Klubit të Stukos?
 5. Cili ishte kryetari i radhës? Po sekretari?

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/ses, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

6. Si e vlerësoni ju sjelljen e profesorit me nxënësit:

- e ashpër
- e ashpër, por e drejtë
- e padrejtë
- tjetër

(Qarkoni shkronjën para përgjigjes së zgjedhur dhe argumentoni përgjigjen tuaj)

7. Si është qëndrimi i djemve para profesorit dhe përballë fjalëve të tij ku i qorton se marrin objekte pa leje dhe se kanë ndërtuar "Klubin e Stukos"?
8. Djemtë para profesorit ndihen:
 - në faj
 - nuk u intereson ajo që ai u thotë(Qarkoni shkronjën para përgjigjes së zgjedhur dhe argumentoni përgjigjen tuaj)
9. Po për ju, cila palë ka më shumë të drejtë, djemtë apo profesori?
Argumentoni përgjigjen tuaj.
10. Cila pjesë e tregimit ju duket më interesante? Pse?
Zgjidheni dhe rilexojeni edhe një herë në klasë.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Keni bërë ndonjëherë ndonjë prapësi në shtëpi ose në shkollë, për të cilën keni qenë i/e detyruar që të mbani përgjegjësi para prindërve ose mësuesit/mësueses? Si jeni sjellë përballë një situatë të tillë? Mendoni sot se keni pasur të drejtë apo gabim? Shkruajeni këtë përvojë në trajtën e një tregimi të shkurtër, të ngjashëm si fragmenti i romanit "Djemtë e Rrugës Pal" që lexuat në këtë mësim.

Mitrush Kuteli

QYSH E GJETI AGO JAKUPI RRUGËN E ZOTIT

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit

Autori i pjesës së përzgjedhur: Mitrush Kuteli

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë stilin e rrëfimit të Kutelit.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema në tabelë.

Tema: Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për Mitrush Kutelin dhe veprën e tij.
- Shpjegohet tema dhe disa karakteristika krijuese të Kutelit si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *Zoti, jeta, vdekja, toka, puna, nipërit, e mira etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 - Kush ishte Ago Jakupi? Si e prezanton atë narratori në fillim të tregimit?
 - Sa vjeç ishte ai?
 - A e ndiente moshën Ago Jakupi apo punonte si të ishte i ri? Çfarë punësh bënte ai?
 - Në çfarë mënyre e kishte vendosur ai pasurinë e vet?
 - Si u përgjigjej Ago Jakupi atyre që e ftonin që të vinin pasuri duke grabitur të tjerët?
 - A falte Ago Jakupi ndonjë gjë nga pasuria e tij? Pse vepronte ai kështu?
 - Çfarë i ndodh djalit të tij, Sulit? Pse?
 - Si e përjeton Ago Jakupi humbjen e të birit?
 - Përse vendos Ago Jakupi të flejë në mal?
 - Çfarë i ndodh atij kur është duke fjetur? Kush i del në ëndërr?
 - Çfarë i kërkon njeriu në të bardha Ago Jakupit që të bëjë herën e parë? E kalon provën Ago Jakupi?
 - Po herën e dytë e çfarë i kërkon njeriu në të bardha Ago Jakupit? E kalon provën e dytë Ago Jakupi?
 - Për çfarë e qorton Ago Jakupin njeriu me të bardha? Si ndihet Agai pasi i del gjumi?
 - Çfarë vendos të bëjë Ago Jakupi në mënyrë që të gjejë rrugën e drejtë? Me çfarë e nis ai këtë ndryshim?

15. Çfarë ndodh me pasurinë dhe familjen e Agait pasi ai u kthye në rrugën e drejtë?
16. A vdes Ago Jakupi si një njeri i lumtur?
17. Bëj një hartim lidhur me rëndësinë që ka për njeriun që të jetë i drejtë dhe t'i ndihmojë të tjerët, me temë "Në gjurmët e Ago Jakupit".

Ferit Lamaj

DHELPRRA E TROJËS

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Dhelprra e Trojës

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ferit Lamaj

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë të përgjedhura nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të kuptojë fabulën dhe ta interpretojë atë gjatë leximit. Ta kuptojë moralin e saj dhe të dallojë motivin e sjelljes së personazheve.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Dhelprra e Trojës**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për temën, veprën apo autorin.
- Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *tradhëti, dinakëri, dhelpër, Troja etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 - Cila është lashtësia për të cilën flasin Kali dhe Dhelprra kur takohen? Për cilën ngjarje e kanë fjalën ata?
 - Me cilin argument jeni dakord: me atë të Kalit, i cili thotë se Dhelprra është më dinake apo me qëndrimin e Dhelprrës se Kali është më dinak? Pse? Argumentoni përgjigjen tuaj.
 - Cili është morali i kësaj fabule për ju?

Hapi III.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/ses, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

Emrat e personazheve të kësaj fabule janë shkruar me shkronjë kapitale (të madhe)? Pse mendoni që autori ka bërë këtë zgjedhje?

Kujto që...

Fabula është një tregim i shkurtër, në vargje ose në prozë që ka si personazhe kafshë, bimë dhe sende; veprimet dhe fjalët e këtyre personazheve të veçanta kanë kuptim alegorik (të figurshëm) dhe japin një mësim ose moral nga përvoja e jetës.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Gjeni pesë fabula të tjera të cilat flasin për mençurinë ose për dinakërinë, sillini në klasë të shkruara në ditar dhe tregojini bukur.

Sulejman Pitarka

TRIMI I MIRË ME SHOKË SHUMË

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Trimi i mirë me shokë shumë

Autori i pjesës së përzgjedhur: Sulejman Pitarka

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, dramaturgjia

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, zberthim teksti, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Interpretim skenik

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë karakteristikat krijuese të dramës, ta interpretojë atë dhe ta vendosë në skenë.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Trimi i mirë me shokë shumë**

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për dramën dhe autorin.
- b) Shpjegohen disa karakteristika kryesore të gjinisë së dramës.
- c) Bëhet leximi i dramës nga mësuesi/ja ose nga ndonjë prej nxënësve.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *dramë, luftë, shqiptarë, tradhëti, shokë, trima, besnikëri, falje etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 1. Për cilën periudhë të historisë bën fjalë kjo dramë?
 2. Çfarë gabimi të rëndë ka bërë Moisi Golemi?
 3. Çfarë qëndrimi janë duke mbajtur luftëtarët lidhur me tradhëtinë e Moisi Golemit? A mendojnë ata që Moisi Golemi duhet dënuar për tradhëtinë e tij?
 4. Po qëndrimi i Skënderbeut përballë mikut që e ka tradhëtuar, cili është? Si vepron ai në fund, a e fal Moisi Golemin?
 5. Po vetë Moisi Golemi, si ndihet për atë që ka bërë?

Hapi III.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/ses, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

6. Si mendoni ju, kur dikush ju tradhton besimin, duhet falur ai njeri? Pse? Argumentojeni përgjigjen tuaj?
7. Si e imagjinoni ju skenën kur Moisi Golemi i kërkon falje për tradhëtinë e tij? Bëni një hartim të shkurtër ku të përshkruani këtë skenë.
8. Njihni raste të tjera tradhëtie nga historia e Shqipërisë ose ajo botërore? Bëni kërkime për këtë në internet ose duke kërkuar në libra dhe shkruani me fjalët tuaja se për cilin rast bëhet fjalë.

PROJEKT

NJË MUAJ GAZETAR

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Një muaj gazetar-PROJEKT

Autori i pjesës së përzgjedhur: Sulejman Pitarka

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë të dhëna nga mësimdhënësi

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë, gazetari

Metodologjia dhe veprimtaritë: Shkrim gazetaresk

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Shkrim gazetaresk/krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të bëjë intervistë dhe gjatë një muaji ai mëson më shumë për rëndësinë e profesionit të gazetarit.

Hapi I:

Tema: Një muaj gazetar-PROJEKT

Fillimisht ju zgjedhni një shok ose shoqe për të bashkëpunuar për një muaj për temën që do të zgjidhni dhe gjininë e gazetarisë që do të provoni.

Ju keni tri gjini alternativë për të zgjedhur:

1. Reportazhin
2. Intervistën
3. Dokumentarin

Hapi II.

Detyrë

- Javën e parë bëni zgjedhjen e llojit të gjinisë së gazetarisë
- Javën e dytë paraqisni në klasë personin/çështjen që keni zgjedhur dhe temën
- Javën e tretë tregoni ecurinë e punës dhe këshillohuni me mësuesin/en për çdo paqartësi
- Javën e katërt paraqisni para klasës punimet tuaja me shkrim dhe të zgjedhet punimi më i mirë që do të marrë titullin "Gazetari/ja e klasës"

Hapi III

Si mendoni?

Si mendoni se mësohet gazetaria duke e praktikuar apo duke e studiuar?

Hapi IV

Shkruaj...

Shkruaj se cilët janë pesë gazetarët më të mirë shqiptarë për ty? Pse mendon kështu? Argumentoje përgjigjen tënde.

SHËNIME:

Mark Milani

LEKË IVANI NGA TRIESHI DHE KNJAZI I MALIT TË ZI

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Lekë Ivani nga Trieshi dhe Knjazi i Malit të Zi

Autori i pjesës së përzgjedhur: Mark Milani

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë dhe kuptojë tregimin dhe të dallojë një lloj rrëfimi dhe tematike ndryshe në këtë pjesë.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema në tabelë.

Tema: **Lekë Ivani nga Trieshi dhe Knjazi i Malit të Zi**

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për Mark Milanin.
- b) Shpjegohen disa karakteristika letrare dhe jo letrare të autorit, si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/ja.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *liri, burrëri, mençuri, nder, etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 1. Për ç'arsye Risto Bozhina Vasojeviqi e qëllloi me pushkë Lekë Ivanin nga Trieshi? A ia arriti ai qëllimit të tij? A vdiq Leka?
 2. Kush e ndihmoi Lekën e plagosur?
 3. Çfarë bënte Vasojeviqët e tjerë kur Lekë Ivani u tregoi se kush e qëllloi?
 4. Cili qe dënimi që i dha gjyqi Risto Bozhina Vasojeviqit?
 5. Çfarë veprimi bëri Lekë Ivani kur mori vesh për dënimin që mori njeriu që u përpoq ta vriste? A u gëzua ai për këtë lajm? Çfarë i kërkoi ai gjyqit?
 6. Si iu përgjigj Knjazi Lekës për kërkesën e këtij të fundit?
 7. Në fund kush u tregua më i mençur, Knjazi apo Leka?
 8. Si përfundon tregimi?

Hapi III.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Rudjard Kipling

LIBRI I XHUNGLËS

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Libri i xhunglës

Autori i pjesës së përzgjedhur: Rudjard Kipling

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me empati fragmentin, të dallojë personazhet e tregimit dhe të diskutojë rreth çështjeve që ngrihen në rubrikat përkatëse.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Libri i xhunglës**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për veprën apo autorin.
- Shpjegohet tema dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi i fragmentit nga ndonjë prej nxënësve.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *fëmijë, xhungël, bota e njerëzve, shtëpi etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 - Përse njerëzit në fshat kanë frikë nga Mogli?
 - Përse Mogli e ka të pamundur që të komunikojë me banorët e fshatit?
 - Për ç arsye prifti i fshatit i thotë Mesuas që Mogli ishte fëmija që asaj ia kishte rrëmbyer tigrin shumë vite më parë?
 - Si vepron Mesuaja? E merr ajo Moglin në shtëpi?
 - Pse ka vështirësi Mogli që të flejë në kasolle? Çfarë gjëje i kujton ajo atij?
 - Kush vjen ta takojë Moglin ndërkohë që ky po flinte jashtë kasolles?

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

- Çfarë porosie i jep vëlla Greiu Moglit lidhur me njerëzit?
- Po Baluja plak si e këshillon Moglin?

Petro Marko

SHPELLA E PIRATËVE

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Shpella e piratëve

Autori i pjesës së përzgjedhur: Petro Marko

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë romanin aventuresk si një lloj i veçantë i romanit. Ai njih personazhet e romanit, botën e fëmijëve dhe dëshirën e tyre për të zbuluar të fshehtat e "Shpellës së Piratëve".

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Shpella e piratëve**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për romanin aventuresk.
- Shpjegohet tema dhe disa karakteristika krijuese të Petro Markos si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga nxënësit.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyç: *shpella, djemtë, piratët, sekret etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 - Cilat janë personazhet e këtij tregimi? Si quhet personazhi vajzë?
 - Cili prej fëmijëve e udhëheq "ekspeditën" për në Shpellën e Piratëve?
 - Për çfarë betohen fëmijët përballë Niko Dabos?
 - Përse peshkatari plak Niko Dabo nuk kishte mbërritur dot deri te Shpella e Piratëve? Deri ku kishte shkuar ai? Çfarë kishte parë atje?
 - Çfarë ishin piratët?
 - Kush ishte Gjikë Gjonbaba? Përse nuk ka guxuar më askush që të futej atje ku u fut ai?
 - Çfarë zotohet Loloja se do të bëjnë fëmijët së bashku? Po peshkatari plak si reagoi në fund?

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Daniel Defó

ROBINSON KRUZO

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Robinson Kruzo

Autori i pjesës së përzgjedhur: Daniel Defó

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë romanin brenda një jave, të shkruajë përmbajtjen e tij dhe të diskutojë rreth çështjeve që ngrihen në rubrikat përkatëse.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Robinson Kruzo**

- a) Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për temën, veprën apo autorin.
- b) Shpjegohet tema disa karakteristika krijuese të Daniel Defós si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga nxënësit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *vetëm, ishull, pyll etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 1. Përse vendosi Robinsoni të rikthehej në anijen e mbytur? Sa larg ishte anija nga bregu?
 2. Sa gjatë eci në rërë Robinsoni përpara se të hynte në ujë dhe të notonte?
 3. Cila qe mënyra që Robinsoni përdori për t'u ngjitur në anije? Çfarë kishte ndodhur me hambarin e saj?
 4. Pse vendosi Robinsoni të ndërtonte një trap ndërkohë që ishte në anije? Përse i duhej atij ky mjet? Cilat qenë mjetet rrethore që ai përdori për këtë qëllim?
 5. Çfarë sendesh futi Robinsoni në sëndukët që gjeti në anije?
 6. Ndërkohë që Robinsoni po merrej me ngarkesën, çfarë ndodhi me rrobat e tij në breg?
 7. Trapi nuk kishte vela apo timon për ta drejtuar drejt bregut? Çfarë e drejtoi Robinsoni për t'ia arritur këtë qëllim?
 8. Cila qe e vërteta e hidhur që zbuloi Robinson Kruzo pasi u ngjiti në kodrën e lartë?
 9. Robinsoni do të flejë, por ndërkohë ka frikë nga sulmi i kafshëve të egra. Çfarë sajoi ai për t'u ruajtur prej tyre?
 10. Sa herë notoi Robinsoni drejt anijes së mbytur gjatë trembëdhjetë ditëve?
 11. Ku vendosi ta ndërtojë strehën e vet Robinson Kruzo? Pse zgjedh ai atë vend?
 12. Çfarë do të bëjë ti po të ishe në një situatë të ngjajshme me atë të Robinsonit?

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/ses, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

12. Si e vlerësoni ju faktin që gjatë fragmentit që lexuat Robinson Kruzoit nuk dorëzohet në asnjë çast para të papriturës që ai gjendet në një ishull të pabanuar dhe se është krejtësisht vetëm? A ju duket kjo shenjë e një karakteri të fortë apo mendoni se ai ishte thjesht një njeri moskokëçarës? Argumentojeni dhe shkruajeni përgjigjen tuaj.
13. Duke kërkuar nëpër anijen e braktisur Robinsoni gjeti diçka që ai e quan “*më e çmuar sesa një anije plot me ar*”? Dhe kjo gjë shumë e çmuar ishte veçse një sënduk me vegla marangozi! Mendoni se në një rrethanë tjetër, d.m.th po të ishte i qetë në shtëpinë e tij dhe pa pasur nevojat që kishte në ishull Robinsoni do ta vlerësonte kaq shumë një sënduk me vegla? Ju ka ndodhur ndonjëherë që diçka (ndonjë objekt, vegël, pajisje etj.) e cila mund t’ju jetë dukur e parëndësishme kur e keni parë në fillim, në një moment tjetër ju ka zgjidhur ndonjë problem? Çfarë kuptojmë ne nga ky rast lidhur me rëndësinë e gjërave në jetën tonë?
14. Përse buzëqesh me veten Robinsoni kur në anijen e braktisur gjen një sasi të parash? Jeni të mendimit që në raste të tilla, pra kur njeriu gjendet në situata të vështira apo edhe të rrezikshme, ai fillon të kuptojë se sendet materiale, sado të çmueshme të jenë, nuk vlejnë asgjë para jetës?
Keni pasur ju ndonjë përvojë personale apo keni dëgjuar raste ku njerëzit kanë vlerësuar më shumë jetën, shëndetin dhe mirëqënien e familjeve të tyre përpara të mirave materiale? Tregojeni dhe shkruajeni në klasë këtë përvojë.
15. Edhe pse “Robinson Kruzoit” është një roman dhe nuk është një përrallë nga e cila ne zakonisht nxjerrim atë që e quajmë “moral” apo “porosi”, mendoni se gjithsesi mund të nxjerrim një moral apo porosi nga fragmenti që lexuam?
Ky mesazh sipas jush është:

16. Kush e rrëfen ngjarjen? Në cilën vetë rrëfehët ajo?

Fragmenti ka më shumë **rrëfim** të veprimeve të Robinson Kruzoit apo më tepër **përshkrim** të mjedisit dhe objekteve? Argumentojeni përgjigjen tuaj.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **DETYRË** dhe që për këtë orë mësimore është:

Bëni një hartim me temë “Unë- Robinson Kruzoit vetëm për një ditë”, ku të tregoni ndonjë rast që ju ka ndodhur juve (apo edhe dikujt që ju njihni) kur jeni gjendur në një situatë të vështirë apo edhe thjesht pak të ngatërruar në shkollë, në familje, në udhëtim etj., dhe ju është dashur që të bëheni të shkathët dhe krijues për t’ia dalë mbanë. Cilat kanë qenë emocionet që keni provuar kur jeni përballur me situatën? Jeni ndier më të rritur pasi ia keni dalë mbanë? Përpiquni ta përshkruani këtë përvojë në mënyrë sa më tërheqëse për shokët dhe shoqet.

SHËNIME:

Hysein Bashiq

DALJA NË DIELL

Lënda: Letërsi

Klasa: VII

Titulli i temës: Dalja në diell

Autori i pjesës së përzgjedhur: Hysein Bashiq

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, analizë, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Analizë e tekstit

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të diskutojë rreth çështjeve që ngrihen në rubrikat TË KUPTOJMË TEKSTIN, të punojë individualisht dhe të dalë në përfundime vetjake në rubrikat TË ANALIZOJMË DHE INTERPRETOJMË TEKSTIN, GJUHA E TEKSTIT si dhe të kryejë në mënyrë të pavarur rubrikën DETYRË.

Hapi I:

Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë.

Tema: **Dalja në diell**

- Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë njohuri paraprake për temën, veprën apo autorin.
- Shpjegohet tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga mësuesi/ja.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten paraprakisht nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi, për të nxitur kujtesën.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *stina, djemtë, plaku, puna etj.*

Hapi II.

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në rubrikat e Hapit II mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

- Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 - Për çfarë flet pjesa që lexuat? Cila është tema e saj?
 - Kush e rrëfen ngjarjen?
 - Cilët janë personazhet që përmenden në këtë pjesë? Cili është personazhi kryesor?
 - Sa djem ka Zyberi? Cilët janë emrat e tyre? Cilat janë punët që bëjnë ata?
 - Për secilin nga djemtë e Zyberit përshkruani karakteristikat e tyre. Gjeni në tekst karakteristikat për secilin prej tyre.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/es, por që nxitet ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrika/t e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë:

Të analizojmë dhe interpretojmë tekstin

- Në këtë tekst përshkrimet janë mjaft të gjalla. Zgjidhni pjesë që ju pëlqen më tepër dhe komentojeni në klasë se pse ju pëlqen.

